



USHTRIA



Viti i 73-të i botimit Nr. 32 (827679)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 14 gusht 2020

Jeni të interesuar për bursa studimi ushtarake në Turqi?



Xhaçka: Janë 8 kuota, ja afati për të aplikuar

Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit, konkretisht në Turqi, ku janë 8 kuota akademike. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, bëri të ditur se afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 17 Gusht 2020. "Krahas hapjes së pro-

gramit bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit. 8 kuota në akademitë e Turqisë janë dispozicion të të rinjve që përmbushin kushtet dhe duan të bëjnë karrierë në FA", shprehet Xhaçka... >>> faqe 5

Drejtuesi model në zemrat dhe mendjet tona

Ndahet nga jeta komandanti i QBO, kolonel Neshet Shena



>>> faqe 2

Gjeneralmajor Begaj përgëzohet nga homologët për detyrën si SHSHPPFA Gjeneralmajor Begaj: Do rrisim bashkëpunimin ushtarak me nisma dhe iniciativa konkrete

Gjeneral Andrzejczak, shefi i Shtabit të Republikës së Polonisë: "Mirëserdhët në grupin e shefave të shtabit dhe suksese në detyrën e re që nuk është e lehtë, por as shumë e vështirë" >>> faqe 3



Batalioni Xhenier-Kompania EOD

Eliminohen 11 predha luftarake afër portit të Sarandës

Efektivët e Kompanisë EOD të Batalionit Xhenier në Komandën Mbështetëse përfunduan me sukses operacionin për evidentimin e 11 predhave luftarake të kalibrave 100 dhe 55 mm të gjetura në vendbazimin ushtarak në afërsi të portit të qytetit të Sarandës. Predhat të cilat përkisnin Luftës II Botërore janë gjetur në të çarët e disa prej shkëmbinjve të këtij vendbazimi...



>>> faqe 3

Aplikimet

675 maturantë zgjedhin të studiojnë pranë AFA

675 maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur të studiojnë pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, që në tetor hap për herë të parë programin bachelor. Më 10 gusht përfundoi afati për këtë kategori aplikantësh të cilët kane plotësuar formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre. "675 maturantë... >>> faqe 5



ANALIZË

Një Ukrainë e pavarur është thelbësore për sigurinë euro-atlantike

MSC.MIMOZA GOLIKJA

>>> faqe 9

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

Takim midis akademikëve për 100-Vjetorin e Luftës së Vlorës

faqe 3

HISTORI

Historia ushtarake për Luftën e Vlorës të vitit 1920

PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

faqe 6

MINISTRJA OLTA XHAÇKA:

Mirënjohje për kontributin njerëzor e profesional të kolonel Neshet Shenës

Ministrja e Mbrojtjes Olta Xhaçka, me anë të një statusi në "Facebook" ka kujtuar Neshet Shenën, kolonelin që u nda nga jeta pas një sëmundje të rëndë. Xhaçka shprehet se Shena do të mbahet mend për faktin se dha kontribut shumë të çmuar për 35 vjet në Forcat e Armatosura, ndërsa shtoi se do të kujtohet kontributi i tij i madh njerëzor e profesional. "Pas një beteje të vështirë me një sëmundje të rëndë, kolonel

Neshet Shena, komandanti i Qendrës së Bashkuar Operacionale, u nda nga jeta duke lënë në hidherim familjen dhe të gjithë ata që e njohën dhe punuan me të, në 35 vite të karrierës në Forcat e Armatosura. Mirënjohje pa kufi për kontributin njerëzor e profesional të një prej oficerëve më të përkushtuar në FA. Ngushëllimet më të ndjera bashkëshortes e dy djemve. U prehsh në paqe, kolonel Shena!" shkruan ministrja Xhaçka.



Drejtuesi model në zemrat dhe mendjet tona

Ndahet nga jeta komandanti i QBO, kolonel Neshet Shena

Pas një sëmundje të rëndë, më 13 gusht 2020, është ndarë nga jeta komandanti i Qendrës së Bashkuar Operacionale, kolonel Neshet Shena. Kolonel Shena u lind më 25 maj 1963 në Progonat të Tepelenës në një familje me ndjenja të theksuara patriotike e lirisdashëse. Nesheti pasi kreu shkollën e mesme në vendlindje me rezultate të shkëlqyera, me dëshirën e madhe për të qenë pjesë e Forcave të Armatosura kreu me sukses të gjitha nivelet e arsimit ushtarak, që nga Shkolla e Bashkuar e Oficerëve në specialitetin e Ndërlidhjes, akademinë dyvjeçare të Shtabit të Përgjithshëm, Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes dhe një sërë kursesh e trajnimesh të tjera brenda e jashtë vendit, të cilat e formuan atë me të gjitha karakteristikat më të mira të një kuadroje ushtarak.

Për më shumë se 35 vjet karrierë si ushtarak aktiv, Nesheti kreu me nder një sërë detyrash të rëndësishme duke filluar nga komandant toge, kompanie, batalioni në Brigadën e Ndërlidhjes në Tiranë, drejtor ndërlidhje në Komandën e Forcës së Bashkuar në Durrës, e deri shef sektori e drejtor i Ndërlidhjes në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, drejtor i Inspektimit në Ministrinë e Mbrojtjes, drejtor i Agjencisë së Informacionit dhe Sigurisë së Mbrojtjes, përfaqësues i lartë i FA shqiptare në Komandën e NATO, ACT në Norfolk të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe së fundi detyrën e komandantit të Qendrës së Bashkuar Operacionale.

Në kryerjen e të gjitha këtyre detyrave Nesheti u shqua për përkushtimin dhe devotshmërinë ndaj interesave të larta të atdheut; detyra, nderi, atdheu për të ishin



Për punën e tij shëmbullore në Forcat e Armatosura, Nesheti ishte vlerësuar me një sërë medaljesh nga autoritetet më të larta të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Armatosura.

gjithçka. Ai ishte mbi të gjitha një kuadër ushtarak me integritet, i vendosur dhe i pa lëkundër në kryerjen e detyrave, por ishte edhe një shok dhe mik shumë i mirë me të gjithë komunitetin e ushtarakëve dhe civilëve në Forcat e Armatosura.

Përveçse një ushtarak e profesionistë i zoti, Nesheti ishte edhe një prind shembullor për dy djemtë e tij Kreshnikun e Erindin dhe bashkëshort i denjë për bashkëshorten e tij Meritën, një mik dhe shok i rrallë për të gjithë ata që punuan dhe e njohën nga afër.

Për punën e tij shëmbullore në Forcat e Armatosura, Nesheti ishte vlerësuar me një sërë medaljesh nga autoritetet më të larta të Ministrisë së Mbrojtjes dhe

Shtabit të Përgjithshëm të Forcave Armatosura.

Kohët e fundit shëndeti i tij u keqësua, ku me gjithë interesimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA, duke e dërguar për kurim edhe jashtë vendit, që e pamundur për ta shpëtuar nga vdekja e parakohshme, shkaktuar nga leucemia akute. Me vdekjen e Neshetit Forcat e Armatosura humbën një kuadër profesionist të shkëlqyer, familja njeriun më të dashur e të pazëvendësueshëm.

Lamtumirë Kolonel Shenaj!

Do mbetesh ushtaraku i shkëlqyer, njeriu i përsosur fjalëpak e punëshumë, profesionisti korrekt, drejtuesi model në zemrat dhe mendjet tona!

U prehsh i qetë!

Presidenti Ilir Meta:

Kolonel Neshet Shena do mbetet shembulli frymëzues i ushtarakut

Presidenti i Republikës Ilir Meta ka shprehur trishtim për ndarjen nga jeta parkohe të Komandantit të Qendrës së Bashkuar Operacionale, Kolonel Neshet Shena Metya shkruan se Kolonel Shena do të mbetet shembull frymëzues i ushtarakut profesionist dhe drejtuesit model në radhët e Forcave tona të Armatosura. "I trishtë lajmi për ndarjen e parakohshme nga jeta të Komandantit të Qendrës së Bashkuar Operacionale, Kolonel Neshet Shena. Me një karrierë të gjatë, të spikatur e të vlerësuar, Kolonel Shena do të mbetet shembull frymëzues i ushtarakut profesionist dhe drejtuesit model në radhët e Forcave tona të Armatosura, njeri me vlera dhe integritet të lartë qytetar. Ngushëllimet më të ndjera bashkëshortes Rita, fëmijëve Kreshnik dhe Nerid, miqve, kolegëve dhe komunitetit të ushtarakëve për këtë humbje të madhe. Lamtumirë Kolonel! U prehsh në paqe! ", shkruan Presidenti Meta.

STAFI

DED KOLA
Shef i Sektorit të
Botimeve & Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza **GOLIKJA**

Gazetarë:
Saimir **ALIJA**

Graphic Designer:
Afërdita **HYSAJ**

ADRESA:
Rruga e Dibrës/
Garnizoni "Skënderbej"

Gjeneralmajor Begaj përgëzohet nga homologët për detyrën si SHSHPFA

Gjeneralmajor Begaj: Do rrisim bashkëpunimin ushtarak me nisma dhe iniciativa konkrete

Gjeneral Andrzejczak, shefi i Shtabit të Republikës së Polonisë: “Mirëserdhët në grupin e shefave të shtabit dhe suksese në detyrën e re që nuk është e lehtë, por as shumë e vështirë”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor, prof. asoc. Bajram Begaj, gjatë javës së parë të punës ka marrë urime për marrjen e detyrës së re. Disa nga këto urime kanë qenë nga homologët e tij, si: shefi i Shtabit të Republikës së Italisë, Hungarisë, Polonisë, Turqisë apo dhe personalitete të tjera si: ministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës së Kosovës, ambasadori i Gjermanisë etj. Ata e kanë uruar për detyrën e re duke shprehur edhe njëherë mbështetjen e tyre për Forcat e Armatosura të RSH dhe vetë shefin e Shtabit të Përgjithshëm.

Gjeneral Andrzejczak, shefi i Shtabit të Republikës së Polonisë, gjatë telefonatës së tij, ndër të tjera u shpreh: “Mirëserdhët në grupin e shefave të shtabit dhe suksese në detyrën e re që nuk është e lehtë, por as shumë e vështirë.” Nga ana e tij, gjeneralmajor Begaj, i ka siguruar homologët e tij dhe jo vetëm, për angazhimin e tij për të përmirësuar dhe çuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ushtarak në nisma të mëtejshme të reja duke i përjetësuar me projekte dhe iniciativa konkrete.

Pjesë e axhendës së shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FARSH në këto ditë kanë qenë edhe takimet prezantuese me atashetë ushtarakë të akredituar në vendin tonë. Një ndër këto takime ishte dhe takimi me atashen ushtarak amerikan, kolonel Hilton, me të cilin, gjeneralmajor Begaj, pati mundësinë e shkëmbimit të ideve për vijimin e bashkëpunimit midis dy vendeve dhe krijimin e mundësive për rritjen dhe forcimin e këtyre marrëdhënieve.



Gjeneralmajor Begaj, i ka siguruar homologët e tij dhe jo vetëm, për angazhimin e tij për të përmirësuar dhe çuar më tej marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ushtarak në nisma të mëtejshme të reja duke i përjetësuar me projekte dhe iniciativa konkrete.

Akademia e Forcave të Armatosura



Takim midis akademikëve për 100-Vjetorin e Luftës së Vlorës

Me rastin e festimit të Festës Kombëtare të 100-vjetorit të Luftës së Vlorës, në Akademinë e Forcave të Armatosura u zhvillua me 11 gusht 2020 një takim bashkëpunues me akademikët e njohur prof. Shaban Sinani në cilësinë e sekretarit shkencor të Akademisë së Shkencave dhe prof. Pëllumb Xhufi nga Akademia e Studimeve Albanologjike. Perfaqësuesit e AFA të drejtuar nga dekan i Fakultetit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kolonel profesor Agim Sula diskutuan me akademikët e njohur mbi programin e aktiviteteve të përbashkëta që do të organizohen me këtë rast. Fokusi kryesor i diskutimeve u përqëndrua në angazhimet e përbashkëta mbi zhvillimin e konferencës shkencore historike “100-vjetori i luftës Kombëtare të Vlorës”, i cili do të mbahet pjesë e parë në teatrin “Petro Marko” në Vlorë, ndërsa pjesa e dytë në Universitetin e Vlorës “Ismail Qemali”, si dhe për realizimin e koncertit festiv nga banda frymore e Forcave të Armatosura. AFA në këtë konferencë do të angazhohet duke trajtuar nga kendvështrimi i historiografisë ushtarake aspekte të luftës së Vlorës.

BATALIONI XHENIER-KOMPANIA EOD

Eliminohen 11 predha luftarake afër portit të Sarandës

Efektivët e Kompanisë EOD të Batalionit Xhenier në Komandën Mbështetëse përfunduan me sukses operacionin për evidentimin e 11 predhave luftarake të kalibrave 100 dhe 55 mm të gjetura në vendbazimin ushtarak në afërsi të portit të qytetit të Sarandës. Predhat të cilat përkisnin Luftës II Botërore janë gjetur në të çarat e disa prej shkëmbinjve të këtij vendbazimi. Nga evidentimi i llojit të municioneve dhe rrezikshmërisë që paraqesnin ato, specialistët EOD dolën në konkluzionin që nga 11 predhat e gjetura, vetëm një predhë e kalibratit 100 mm u konsiderua e pa lëvizshme e cila përbënte rrezik jo vetëm për vendbazimin ushtarak, por dhe për banesat afër tij.

Për këtë arsye kjo predhë u asgjësua në vend duke zbatuar protokollin tepër rigoroz të sigurimit të zonës, rrethimit të saj, vendosja e shiritit dhe



largimi i personelit të pacertifikuar në një rreze prej 500 m. Ndërsa 10 predhat e tjera të kalibrave 100 dhe 55 mm u transportuan dhe u magazinuan

në depot e Batalionit Xhenier dhe pas procedurave standarde do të asgjësohen në poligonin e miratuar për këtë qëllim.

QENDRA E PERSONEL REKRUTIMIT

Starton rekrutimi, 8 (tetë) të drejta studimi në Akademitë Ushtarake të Turqisë

Shkolla e Lartë e Forcës Tokësore, 4 (katër) kuota. Shkolla e Lartë e Forcës Detare, 1 (një) kuotë. Shkolla e Lartë e Forcës Ajrore, 1 (një) kuotë. Fakulteti Mjekësisë Gulhane, 2 (dy) kuota. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është deri në 17 Gusht 2020

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për studime në Akademitë Ushtarake të Turqisë, 8 (tetë) të drejta studimi si më poshtë vijon: Shkolla e Lartë e Forcës Tokësore, 4 (katër) kuota. Shkolla e Lartë e Forcës Detare, 1 (një) kuota. Shkolla e Lartë e Forcës Ajrore, 1 (një) kuota. Fakulteti Mjekësisë Gulhane, 2 (dy) kuota. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 Gusht 2020.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të ketë shtetësi shqiptare. Të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të jetë në moshë jo më pak se 18 vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të mos jetë i martuar, i fejuar, i ve ose të mos bashkëjetojë. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë një trup me fizik të rregullt, të shëndetshëm nga të gjitha pikëpamjet, pa asnjë mangësi apo shenja që deformojnë pamjen, të mos ketë tatuazhe ne pjesët e trupit, të mos jetë dystaban, të mos ketë në trup plagë apo shenja djegie, të jetë me flokë dhe të mos ketë sëmundje të lëkurës. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera; të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatiche, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike. Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake në Turqi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës parauniversitare mbi 8 (tetë), mesatarja e notave të të gjitha viteve të gjimnazit për lëndët Matematik, Fizik dhe Kimi të jetë mbi 8 (tetë) dhe notat e maturës shtetërore të jenë mbi 8 (tetë). Kandidatët nuk mund të regjistrohen për ndjekjen e studimeve në institucionet arsimore ushtarake jashtë vendit, në rast se: a. Zotërojnë diplomë ushtarake për nivelin arsimor për të cilin aplikojnë; b. Kanë fituar më parë statusin



e studentit ushtarak; c. Kanë qenë kontingjent i Forcave të Armatosura për ndjekjen e studimeve ushtarake brenda dhe jashtë vendit dhe nuk i kanë përfunduar studimet. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përmendura më sipër, s'kualifikohet.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët për regjistrim duhet të paraqesin pranë Zyrës së Pranimit Tiranë dokumentacionin e mëposhtëm: Kërkesë me shkrim e nënshkruar nga kandidati për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake të Turqisë. Formular me të dhënat personale sipas formatit të përcaktuar, Aneksi A. Fotokopje e noterizuar e dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton

përfundimin e arsimit përkatës së bashku me certifikatën dhe listën e notave. Fotokopje e kartës së identitetit. Fotografii për dokument (4x6), 2 (dy) copë. Fotokopje të pasaportës e vlefshme për jashtë

shtetit. Raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes në qendrën shëndetësore të vendbanimit, ku deklarohet se kandidati është i aftë për punë. Ekzaminimet mjekësore për agjentë infektiv (Hepatit B,



Hepatit C, HIV/AIDS, Sifiliz) dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut dhe/ose bankat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. Librezën e vaksinave. Formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë Qendrës së Personel Rekrutimit në momentin e dorëzimit të dokumentacionit.

Dokumentacioni që duhet të paraqesin kandidatët e kualifikuar pas përfundimit të testimit, brenda 5 ditëve:

Dëshmi penaliteti. Vërtetim nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor. Vërtetim nga prokuroria që nuk është në proces hetimi. Vërtetim nga përmbartimi. Raportin mjekësor të lëshuar nga Komisioni Mjekë-Ligjor (KML) i Njësisë Mjekësore Ushtarake.

Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj: 18.08.2020 Testi Fizik: 18.08.2020 Testi Intelektual: 19.08.2020 Testi Psikologjik: 19.08.2020

Shënim. Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet vetëm në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar. Deklarimi i rremë shkakton përgjegjësi penale sipas ligjit dhe pas sjellë përjashtimin tuaj nga çdo procedurë e mëtejshme.

AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA

675 maturantë zgjedhin të studiojnë pranë AFA

675 maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur të studiojnë pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, që në tetor hap për herë të parë programin bachelor. Më 10 gusht përfundoi afati për këtë kategori aplikantësh të cilët kanë plotësuar formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre. “675 maturantë, të cilët kanë përfunduar arsimin e mesëm këtë vit, kanë zgjedhur të studiojnë pranë Akademisë së Forcave të Armatosura, që në tetor hap për herë të parë programin bachelor. Por aplikimi ishte i hapur për maturantët e viteve të shkuara. Më 10 gusht përfun-

doi afati për këtë kategori aplikantësh, të cilët kanë plotësuar formularin pranë gjimnazit ku janë diplomuar, duke zgjedhur Akademinë e Forcave të Armatosura si një ndër preferencat e tyre”, tha Xhaçka. “Akademia e Forcave të Armatosura është një mundësi e jashtëzakonshme. Pagesë mujore ndihmëse për çdo student për të gjithë periudhën e studimit. Akomodim dhe ushqim falas për 3 vitet e studimit në Akademi. Tarifë studimi 0 lekë në vit. Punësim i sigurt pas përfundimit të studimeve. Duke zgjedhur studimet në Shkencat Ushtarake, keni zgjedhur një karrierë sa të pasur, aq edhe të sigurt! Bëhuni elita e së ardhmes në Forcat e Armatosura”, shprehet Xhaçka.



JENI TË INTERESUAR PËR BURSA STUDIIMI USHTARAKE NË TURQI?

Xhaçka: Janë 8 kuota, ja afati për të aplikuar

“Krahas hapjes së programit bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit”

Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit, konkretisht në Turqi, ku janë 8 kuota akademike. Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka, bëri të ditur se afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit është data 17 Gusht 2020. “Krahas hapjes së programit bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura, Ministria e Mbrojtjes do të vijojë ofrimin e bursave të plota, për studimet në akademitë ushtarake jashtë vendit. 8 kuota në akademitë e Turqisë janë dispozicion të të rinjve që përmbushin kushtet dhe duan të bëjnë karrierë në FA”, - shprehet Xhaçka. Ajo sqaron dhe cilat kurrikula ofrohen në bursa. “4 bursa për Forcën Tokësore; 1 bursë për Forcën Detare; 1 bursë për Forcën Ajrore; 2 bursa për Fakultetin e Mjekësisë “Gulhane”, - sqaron Xhaçka, e cila kujton se dita e fundit e aplikimit është data 17 gusht 2020.

Ministria e Mbrojtjes në faqen e saj zyrtare njofton dhe kriteret që duhet të plotësojë aplikanti dhe rrugën që duhet të ndjekur për përfutur nga bursa. “Aplikanti duhet të ketë shtetësi shqiptare. Ai duhet të ketë kryer arsimin parauniversitar brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe ekuivalente nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë ose në raste të veçanta të jetë në vitin e fundit të studimeve parauniversitare. Të mos jetë i dënuar apo i ndjekur penalisht nga organet e drejtësisë. Të jetë në moshë jo më pak se 18-vjeç dhe jo më shumë se 20 vjeç, në ditën e fillimit të vitit akademik. Të mos jetë i martuar, i fejuar, i ve ose të mos bashkëjetojë. Të jetë i aftë nga ana shëndetësore. Të ketë gjatësinë trupore jo më pak se 170 cm për meshkujt dhe jo më pak se 165 për femrat dhe pa tatuazhe. Të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (Sëmundje Seksualisht të Transmetueshme) të tjera. Të mos ketë kaluar apo të vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepatike, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe lëvizjes) apo të ketë qenë ose jetë përdorues i lëndëve narkotike”, -sqaron Ministria e Mbrojtjes. “Kandidatët që do të aplikojnë për ndjekjen e studimeve pranë Akademive Ushtarake në Turqi të plotësojnë kriterin e notës mesatare të shkollës para universitare mbi 8, mesatarja e notave të të gjitha viteve të gjimnazit për lëndët Matematik, Fizik dhe Kimi të jetë mbi 8 dhe notat e maturës shtetërore të jenë mbi 8”, - vijon sqarimi. Po ashtu Ministria e Mbrojtjes bënë me dije dhe datat e testimit janë në datat 18-19 gusht: Testi i Gjuhës së Huaj: 18.08.2020, testi Fizik: 18.08.2020, testi Intelektual: 19.08.2020 dhe testi Psikologjik: 19.08.2020.



AFA



Intervistat do të jepen në datat 18 dhe 19 gusht

Maturantët të cilët kanë shprehur dëshirën për ndjekur studimet për bachelor në Akademinë e Forcave të Armatosura kanë filluar regjistrohet. Kështu nga data 7 deri 11 gusht është bere dorëzimi i dokumentacionit pranë Sekretarisë Mësimore të AFA, më datë 13 deri 14 gusht është bërë kontrolli fizik, kurse javën që vjen, konkretisht më datë 18 dhe 19 gusht do te ipen intervistat.

ZJARRET NË VEND

Për fikjen e tyre u përdorën pajisjet e dhuruara nga Ambasada e SHBA-së



“Dhurimi i pajisjeve të ndihmës humanitare është shembulli i fundit i bashkëpunimit të palëkundur dhe të qëndrueshëm midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë”.

nga tymi, si dhe veshje dhe pajisje mbrojtëse e rezistente ndaj zjarrit, për të rritur mbrojtjen dhe sigurinë e zjarrfikësve dhe punonjësve të ndihmës së parë. “Dhurimi i pajisjeve të ndihmës humanitare është shembulli i fundit i bashkëpunimit të palëkundur dhe të qëndrueshëm midis Shteteve të Bashkuara dhe Shqipërisë”, thuhet në një njoftim të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë.

Historia ushtarake për Luftën e Vlorës të vitit 1920



PROF. ASOC. DR. BERNARD ZOTAJ

Analizë për aspekte të veçanta të historisë ushtarake

Studimi i Luftës së Vlorës të vitit 1920 që është një ndër periudhat më të lavdishme në historinë luftarake të popullit shqiptar, përbën një ndër detyrat madhore të historiografisë shqiptare në përgjithësi dhe të asaj ushtarake në veçanti. Edhe pse Lufta e Vlorës nuk ka mbetur jashtë vëmendjes të historiografisë shqiptare, studimet për të, sidomos të karakterit monografik për aspekte të veçanta të historisë ushtarake janë ende të kufizuara.

Dihet se fillimi i një lufte kushtëzohet nga faktorë politik dhe shoqëror, ku dhe përcaktohen objektivat politike e gjeostrategjike që duhen arritur. Ndërsa arti ushtarak është mendja e luftës, truri i saj. Ky art përcakton Forcat e Armatosura që do të zhvillojnë këtë luftë, mënyrat e organizimit e të drejtimit të tyre, planëzimin e operacioneve luftarake, metodat e taktikës dhe të luftimit, rezervat, duke synuar arritjen e objektivit strategjik, pra sigurimin e fitores. Parë në këtë këndvështrim, arti ushtarak i Luftës së Vlorës të vitit 1920, për vet origjinalitetin e tij paraqet vlera të veçanta. Po si ka reaguar historia ushtarake në studimin e artit ushtarak të kësaj lufte gjatë një periudhe rreth 100 vjeçare?

Në dhjetëvjeçarët e parë pas saj deri në çlirimin e vendit nga pushtuesit nazi-fashistë, nuk është bërë ndonjë punë studimore e organizuar, përveç bërjes së listave të dëshmorëve dhe të plagosurve të saj.

Për këtë luftë filloi të flitej dhe të bëhej më shumë pas çlirimit. Në botimet e pasçlirimit edhe për Luftën e Vlorës të vitit 1920, pavarësisht nga përpjekjet e studiuesve për të dhënë punime mbi baza e kritere shkencore, faktori ideologjik ka lënë gjurmët e veta. Kjo është shprehur në atë metodologji të ngurtë, e cila e udhëhequr nga tendencioziteti klasor, ka synuar t'i shohë gjërat bardh e zi, e prirur për të kritikuar objektivitetin borgjez, mjaft faktorë i ka analizuar në mënyrë subjektivistë, që në ndonjë rast ka çuar në nënvleftësimin apo edhe keqinterpretimin e faktorëve të jashtëm, në lënien në harresë apo edhe në injorimin e individëve të caktuar etj.

Por, në tërësinë e studimeve të botuara gjatë viteve 1950-1970, Lufta e Vlorës është analizuar në këndvështrim politik-shoqëror dhe me ndonjë trajtesë të përgjithshme në aspektin e historisë ushtarake. Një kumtesë e titulluar "Çështje të strategjisë dhe të taktikës në Luftën e Vlorës", të përgatitur nga Skënder Isaku, është botuar në librin "Kongresi i Lushnjës dhe Lufta e Vlorës" në vitin 1974.

Historianët ushtarak dhe vlera e faktorit ushtarak

Një shtysë të mëtejshme ka dhënë trajtesa e "Artit Ushtarak të Luftës së Vlorës në vitin 1920", në studimin e përgatitur nga Prof. Dr. Shahin Leka



me rreth 80 faqe të botuar në Akademinë Ushtarake (sot Akademia e Forcave të Armatosura), në vitin 1979. Më tej ky autor boton dhe dy artikuj për aspekte të Artit Ushtarak në revistën "Për mbrojtjen e Atdheut" të titulluar "Lufta e Vlorës një fitore e madhe historike e popullit shqiptar (nr. 6, viti 1980) dhe "Shpërthimi i rajonit të fortifikuar dhe çlirimi i qytetit të Vlorës në luftën e 1920-ës" (nr. 7, viti 1981).

Gjithashtu në aspektin ushtarak Lufta e Vlorës e vitit 1920 është trajtuar edhe në një krah të librit "Historia e artit ushtarak shqiptar nga lashtësia deri

Më tej janë dhe monografia "Osman Haxhiu" dhe "Rilindasi i Vlorës Ibrahim Abdullahu", "Hamza Isaraj, një jetë në shërbim të kombit" të Prof. Dr. Bardhosh Gaçe, "Lufta e Vlorës në kujtimet e mia" e Gani Iliaz Abazi etj. Lufta e Vlorës është pasqyruar edhe në krijime letrare, interes paraqet romani i Petro Markos "Ultimatum" botuar në vitin 2002, "Njeriu me nofulla të hekurta" i Eqerem Canaj, "Sezau" i Luan Toto, filmi "Gonat përmbi tela" i Duro Mustafaj etj.

Rritja e nivelit të botimeve në fushën e artit ushtarak arrihet në

të jashtëm e kur brenda vendit lëvizja esadiste ishte në veprim, është një dëshmi e qartë e besimit dhe mundësive të popullit shqiptar në forcat e veta. Është meritë e lëvizjes patriotike shqiptare, e cila në kushtet kur fuqitë imperialiste e shikonin rezistencën e popullit shqiptar me mospërfillje dhe ja mohuan të drejtën e tij kombëtare më të lartë, diti të ketë besim në mundësitë dhe forcat e tij, sepse atdheu qëndron e lartësohet, lexojmë në dokumentet e kohës, duke u mbështetur në supet e bijëve të vet. Kur spikatin e dalin në shesh vullneti, qëndrueshmëria dhe rezistenca e një



në vitin 1939". Në vitin 2002 botohet në Shqipëri libri i Ago Agaj "Lufta e Vlorës", botuar në SHBA në vitin 1969. Vlerat e këtij libri i cili rrok një këndvështrim të gjerë e na jep një informacion të pasur mbështetur edhe në dokumentacion, rriten sidomos se vetë autori është pjesëmarrës i kësaj lufte. Ky libër paraqet interes të veçantë në fushën e artit ushtarak.

Pas rënies së diktaturës së proletariatit dhe kalimin në sistemin e demokracisë pluraliste, Prof. M. Çami në vitin 2000 boton librin me karakter përgjithësues "Lufta e Vlorës". Vlerësime jepen për Luftën e Vlorës të vitit 1920 në librat me kujtime të Eqerem bej Vlorës dhe Syrja bej Vlorës, botime të viteve 2003 dhe 2013.

botimin e librit me karakter monografik "Arti ushtarak në Luftën e Vlorës të vitit 1920" me autorë Shahin Leka dhe Bernard Zotaj. Libri ju bën një trajtim të veçantë faktorëve të fitores të Luftës së Vlorës të cilët janë tepër të ndërthurur me njeri-tjetrin, të cilët janë sa ushtarakë aq edhe politikë, sa të brendshëm, aq edhe ndërkombëtarë. Libri përshkruan epërsinë që pati vlera e faktorit ushtarak, sidomos fitoret e arritura gjatë fazës së parë, që bënë të mundur gjallërimin e faktorëve politikë e për pasojë qeveria italiane u detyrua të pranojë dështimin e të nënshkruaj protokolllin e 2 gushtit 1920. Fitorja që arriti populli shqiptar në një luftë të pabarabartë e në kushte të vështira strategjike, duke qenë i rrethuar nga armiq

kombi... atëherë lumturia dhe shpëtimi janë patjetër të siguruara.

Faktorët që ndikuan për arritjen e suksesit

Në varësi nga kushtet konkrete strategjike ushtarake, diti të gjejë format më të përshtatshme të organizimit ushtarak nëpërmjet krijimit të çetave të fshatrave, çetave të krahinave dhe të komiteteve të "Mbrojtjes Kombëtare", të cilat ishin shprehje të traditave luftarake dhe e aftësisë të popullit për t'i dalë zot mbrojtjes së vet. Këto forma ishin të thjeshta, operative, i përgjigjeshin forcave, mjeteve e mundësive dhe u treguan të afta për plotësimin e detyrave të rëndësishme

luftarake. Ato siguruan shpejtësi në mobilizimin, lehtësi në veprimet taktike dhe mundësi për të përdorur si metodat e luftës partizane, ashtu edhe ato të një lufte të rregullt frontale.

Organizimi ushtarak i forcave kryengritëse në Luftën e Vlorës bëri të mundur të zgjidhej drejt një nga problemet më të mprehta të strategjisë, problemi i drejtimit të luftës. Megjithëse Lufta e Vlorës u zhvillua në një kohë kur lëvizja patriotike shqiptare kishte krijuar një qendër të vetme koordinuese, në rrethanat kur qeveria e Tiranës për arsye politike e diplomatike nuk duhej të angazhohej direkt në drejtimin e luftës, drejtimi i saj u realizua nga Komiteti i "Mbrojtjes Kombëtare" të Vlorës, i cili veprimi në pajtim me frymën e pikësynimet e Kongresit të Lushnjës e qeverisë së Tiranës. Kjo ishte një veçori e strategjisë që dëshmon për aftësitë e popullit tonë që në kushte të veçanta të gjejë forma origjinale e të përshatshme drejtimi.

Një nga tiparet e rëndësishme të strategjisë së Luftës së Vlorës ishte realizimi i disa masave të maskimit operativ-strategjik, si përgatitja e kryengritjes me fshehtësi e shpejtësi, qëndrimi në pamje asnjëherë të qeverisë së Tiranës ndaj luftës së armatosur të Vlorës, përpjekjet në terrenin diplomatik që ajo zhvillonte me qeverinë e Romës etj. Këto masa nga njëra anë, si dhe qëndrimi mospërfillës e aventuresk i gjeneralëve italianë ndaj forcave kryengritëse, e vunë komandën italiane përballë të papriturave dhe u bënë një faktor i rëndësishëm për suksesin strategjik të luftës.

Shpejtësia në veprimet luftarake dhe aktiviteti i forcave kryengritëse nga njëra anë, si dhe pasiviteti në tërësi i mbrojtjes italiane nga ana tjetër, u bënë faktorë të rëndësishëm për arritjen e suksesit në luftim si gjatë fazës së parë ashtu edhe gjatë fazës së dytë. Sulmet e pandërprera me forca të kufizuara që u bënë veçori e taktikës gjatë fazës së dytë, nuk i lanë forcat italiane të merrnin frymë, i mbajtën në panik e në tension të vazhdueshëm nervor dhe i siguruan forcave kryengritëse iniciativën. Në këtë luftë përdorim të gjerë morën veprimet luftarake mësimore, por në momente të caktuara u përdorën dhe luftimet mbrojtëse. Taktika e luftimeve mbrojtëse u karakterizua gjithashtu nga qëndrueshmëria, aktiviteti, ndërtimi i kurtheve, pritave etj.

Lufta e Vlorës e vitit 1920 është një shembull i vitalitetit dhe energjisë luftarake të një populli që u ngrit në këmbë për të mbrojtur me gjak lirinë dhe pavarësinë e vet. Ajo mbeti e gjallë në kujtimet e popullit shqiptar, u bë një thesar i paçmuar i traditave luftarake të tij, u trashëguua e u ngrit në një shkallë të lartë nga formacionet partizane të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Në kuadrin e 100 vjetorit të Luftës Kombëtariste të Vlorës ka një rritje të konsiderueshme të trajtesave me njohuri në fushën e historisë së artit ushtarak dhe shkrime të përgjithshme të cilat duhen thelluar për njohuri në fushën ushtarake.

Qendra e Personel Rekrutimit, do të rekrutojë kandidatë për të ndjekur studimet për Përgatitjen e Oficerit të Ri në Akademinë e Forcave të Armatosura, për vitin akademik 2020 -2021, për 60 (gjashtëdhjetë) të drejta studimi, sipas specialiteteve ku arsimiti universitar i përafrohet si vijon: Personel (Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Fakulteti Juridik), Ndërlidhje (Fakulteti i Inxhinierisë Elektronike), Logjistike (Fakulteti Ekonomik), Xhenio (Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit), Forcë Detare (Inxhinieri Navale), Pilot (Inxhinieri Mekanike), Mjekësi (Fakulteti i Mjekësisë), Sinoptikë (Inxhinieri Gjeoinformatik dhe Gjeografi), Këmbësori (Fakultetet e tjera) Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është deri në 17 korrik 2020. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit është shtyer deri në 28 gusht 2020.

Kriteret e pranimit të kandidatëve:

Të jetë shtetas shqiptar; të mos jetë dënuar nga gjykata për vepra penale; të mos jetë në ndjekje penale; të mos jetë në proces gjykimi penal nga gjykata; të ketë figurë të pastër morale; të mos ketë probleme me deportimin; të mos ketë probleme me drogën dhe alkolin; të mos jetë person i dyshuar, i padëshirueshëm, i evidentuar dhe implikuar nga organet e zbatimit të ligjit për veprimtari të kundraligjshme apo kriminale; në momentin e titullimit oficer aktiv, nuk duhet të ketë mbushur moshën 27 vjeç (01 Gusht 2021). Përjashtim bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen oficer, të cilët do të jenë personel mjekësor i FA-së dhe që në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç (01 Gusht 2021); të kenë gjatësinë trupore mbi 170 për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat; të jetë shpallur fitues në përfundim të konkurimit; të jetë vlerësuar i aftë për të shërbyer në FA gjatë ekzaminimit mjekësor nga NJMU-ja e FA-së; të ketë rezultuar pa probleme gjatë verifikimit të kushtit të sigurisë të kryer nga strukturat përgjegjëse, të mos jetë bartës i virusit HIV, Hepatit B dhe SST (sëmundjeve seksualisht të transmetueshme), të mos vuajë ndërkohë nga sëmundje të tjera të zemrës, veshkave, hepaticke, pulmonare, neuropsikiatrike, sistemit lokomotor (sistemit kockor dhe i lëvizjes) apo të jetë përdorues i lëndëve narkotike; të jenë në zotërim të diplomës së arsimit të lartë, (minimumi beachelor) brenda ose jashtë vendit, të njohur dhe të ekuivalentuar nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve të Republikës së Shqipërisë dhe të ketë notën mesatare të të gjitha viteve të arsimit të lartë, jomë pak se 6 (gjashtë); të mos jetë i larguar nga puna në administratën qendrore ose lokale (nëse ka qenë i



Akademia e Forcave të Armatosura

Viti akademik 2020-2021, aplikoni për 60 të drejta studimi

Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit pranë Qendrës së Personel Rekrutimit shtyhet deri më 28 gusht 2020



punësuar para aplikimit), për shkelje të dispozitave të kodit të punës ose legjislacionit në fuqi.

Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e FA-së (nga rradhët e ushtarëve dhe nënoficerëve) përveç kriterëve të cituara më sipër duhet të kenë vlerësimin e fundit të punës jo më pak se “shumë mirë”; të mos kenë asnjë masë disiplinore në fuqi. Kandidati që nuk plotëson qoftë edhe një nga kriteret e përcaktuara, skualifikohet.

Procedurat e aplikimit:

Kërkesën për të marrë pjesë në konkurrim, kandidatët ia adresojnë pranë Qendrës së Personel-Rekrutimit. Kërkesa do të bëhet sipas modaliteteve të trajtuara në Aneksin A. Kandidatët që rekrutohen nga rradhët e ushtarëve/detarëve apo nënoficerëve aktivë, një kopje të kërkesës do t’ia drejtojnë komandës ku kryejnë shërbimin aktiv. Komandat brenda 5 ditësh nga marrja e kërkesës lëshojnë një rekomandimin për

pjesëmarrjen e kandidatit në konkurrim dhe cilësitë e tij.

Dokumentet për regjistrim:

Kandidatët që do të rekrutohen për ndjekjen e studimeve brenda vendit, duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: a) Në fazën e regjistrimit kërkesë me shkrim; formular me të dhëna personale sipas formatit të përcaktuar në aneksi A; fotokopje e kartës së identitetit; fotokopje e noterizuar e

dokumentit zyrtar (diplomës) që vërteton përfundimin e arsimimit të lartë së bashku me listën e notave të lëndëve; fotografi për dokument (4x6), 2 copë; formularët e vetëdeklarimit, të cilët plotësohen pranë QPR-së në momentin e dorëzimit të dokumentacionit; raport mjekësor të lëshuar nga mjeku i familjes i qendrës shëndetësore të vendbanimit. analizat e gjakut për hepatitin B dhe C, HIV/AIDS dhe grupin e gjakut të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Transfuzionit të Gjakut ose bangat e gjakut apo drejtoritë e Shëndetit Publik në rrethet ku banojnë. b) Në përfundim të testimit; Kandidatët që janë kualifikuar në testimet e zhvilluara, brenda 5 ditëve duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm: dëshmi penaliteti; vërtetim nga gjykata; vërtetim nga prokuroria; vërtetim nga përbarimi; raporti mjekësor i lëshuar nga komisioni mjeko-ligjor i Njësisë Mjekësore Ushtarake. Qendra e Personel Rekrutimit të sigurojë dokumentacionin, i cili mund të shkarkohet online nëpërmjet portalit qeveritar “e-albania”, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Kandidatët të sigurojnë vetë dokumentacionin e kërkuar në rastet kur për arsye teknike ai nuk mund të shkarkohet nëpërmjet portalit nga QPR-ja.

Datat e testimit:

Testi i Gjuhës së Huaj në gjuhën anglisht do zhvillohet 01.09.2020, Testi Fizik do të zhvillohet në datë 02.09.2020, Testi Intelektual zhvillohet në datë 03.09.2020 kurse Testi Psikologjik do të zhvillohet në datë 04.09.2020.

KANADEZI DAN BLACK, ANALISTI I SFIDAVE TË SIGURISË SË NATO-S

Dan Black: "Eshtë detyra ime të veproj si një agjent kibernetik"

Dan Black punon me kolegët e vendeve të NATO-n, me agjenci të specializuara ushtarake, për të përgatitur informacione që i ndan me 30 aleatët e NATO-s

Dan Black është një analist i rëndësishëm në Selinë e NATO-s, në Divizionin e Sfidave të Sigurisë në zhvillim të NATO-s. Ai është qytetar kanadez dhe merret me çështjet aktuale dhe të ardhshme të sigurisë. "Eshtë detyra ime të veproj si një agjent kibernetik për të zbuluar gjurmët e gishtërinjve, t'i copëtoj ato dhe të rilevoj aktivitetin me qëllim të keq, duke kërkuar modele që mund të ndihmojnë në identifikimin dhe parandalimin e një aktiviteti të ngjashëm dashakeq në të ardhmen", -shpjegon Dan. NATO mbështetet në komunikimet dhe sistemet e informacionit elastik, ose "rrjetet", për të kryer punën e saj. Një kërcënim i izoluar kundër një kompjuteri ose rrjeti të vetëm ka mundësinë që të ketë efekte vijuese në sisteme të tjera të ngjashme ose të lidhura, dhe nganjëherë me pasoja më të rënda. "Për shembull, një kompjuter i vetëm i shënjestruar me sukses nga një kërcënim në internet, mund të ketë potencialin të rrezikojë informacionin e ndjeshëm, të vendosë trupat në mënyrë të dëmtuar ose të prishë sistemet shoqërore siç janë spitalet, rrjetet energjetike, apo edhe teknologjia që i bën zgjedhjet të zhvillohen pa probleme", -përshtet Dan.

Me kërcënime të shumta kibernetike të reja që raportohen çdo ditë, Dan merr nga të gjitha ngjarjet dhe zbulon se çfarë rreziku i ekspozohet NATO-s dhe si të zbusë këtë rrezik. "Pra, ndërsa shfaqet një kërcënim i ri i mundshëm, ne përpiqemi të mbledhim sa më shumë informacione që të jetë e mundur për të kuptuar me shpejtësi se cilat efekte dytësore të paparashikuara mund të kenë kërcënimi në internet, dhe si ato efekte mund të ndikojnë në NATO dhe aleatët e saj".

Dan punon me kolegët e tij në të gjithë NATO-n, në Seli, në agjenci të specializuara dhe në komanda ushtarake, për të përgatitur informacionin. Ai më tej, e ndan këtë analizë me të 30 aleatët e NATO-s, në mënyrë që ata të mund të përfitojnë nga analiza e NATO-s në përpjekjet e tyre të mbrojtjes kibernetike.

Lufta kundër dezinformimit

Një aspekt tjetër i punës së Danit është të kontribuojë në luftimin e ndërmarrjeve të dezinformimit nga palët e treta. Aktivitete të tilla manipulojnë fakte ose injektojnë gënjeshtër në media kryesore ose media sociale, ku njerëzit zakonisht kërkojnë informacionin e tyre. Fushatat dezinformuese kundër NATO-s dhe aleatëve të saj synojnë të minojnë opinionin publik për NATO-n dhe përpjekjen për të përçarë Aleancën. "Kjo mund të jetë në shumë forma, të tilla si zvogëlimi i mbështetjes publike për një politikë ose mision të NATO-s, përpjekje për të ngritur aleatët kundër njëri-tjetrit, ose promovimin e ndjenjave anti-NATO", -përshtet Dan. Për të luftuar kundër veprimtarive dezinformuese, Dan identifikon në mënyrë aktive fushatat dhe taktikat, teknikat dhe procedurat e përdorura



nga aktorët me qëllim të keq para se të arrijnë një audiencë të madhe. "Ashtu si kërcënimet në internet, dezinformatat kryesisht dorëzohen dixhitale. Kjo do të thotë që të njëjtat lloje të provave të përdorura për të gjurmuar aktivitetin e gabuar në inter-

net, mund të përdoren gjithashtu për të ndihmuar në gjurmimin e fushatave dezinformuese, për të kuptuar më mirë sesi operohen, dhe vlerësojnë se çfarë synojnë të arrijnë", -thotë Dan. Ky informacion u jepet me pas divizioneve të tjera të NATO-s dhe

të gjithë aleatëve për të realizuar përpjekjet e tyre përkatëse për përgjigjen e dezinformimit.

Vazhdimisht për tu përgatitur

Përveç aktiviteteve të tij të përditshme, Dan siguron gjithashtu qëndrimet e NATO-s, të përgatitura për të adresuar kërcënimet në të ardhmen. "Unë bëj një studim të thelluar në grupet e kërcënimeve në internet me qëllim që të kuptoj motivet e tyre afatgjata, ndryshimet në taktikat e tyre dhe cilat modele të veprimtarisë së tyre mund të na tregojnë për të kuptuar më mirë kërcënimet në të ardhmen", -shpjegon Dan. Dan bashkëpunon ngushtë me ekspertë nga aleatët e NATO-s dhe me partnerët, përfshirë Bashkimin Evropian, si dhe industrinë për të përmirësuar mirëkuptimin dhe përgjigjen e tyre të përbashkët ndaj kërcënimeve të reja dhe të shfaqura. "NATO është një platformë e paçmueshme për zhvillimin e partneriteteve të forta, të besueshme që mund të angazhohen dhe lidhin palët e interesuara dhe të stimulojnë bashkëpunimin e nevojshëm për të përmirësuar mbrojtjen tonë kolektive në internet", -vërejt Dan.

Një ish-gamer profesionist

Dan gëzon çdo pjesë të punës së

tij. Duke punuar si një analist kërcëni-mi në internet e vendos atë drejtpërdrejt në linjat e para të mbrojtjes së informacionit të NATO-s. "Nuk ka asgjë më të dobishme se sa të jesh në gjendje të shohësh kontributet e tua në mënyrë aktive të formuara, sesi NATO i përgjigjet kërcënimeve aktuale dhe të ardhshme", -thotë Dan. Ai, si ish-gamer profesionist u rrit duke luajtur të gjitha llojet e lojërave video me vëllezërit e tij. Ai garoi në turnet ndërkombëtare të lojërave në të gjithë botën, dhe në shumë raste, madje ai pati privilegjin të përfaqësonte Kanadanë në skenën ndërkombëtare. Nga këto përvoja, Dan rriti interesin e tij për çështjet ndërkombëtare, dhe më vonë në NATO. "Familja ime sheh ngjarje në internet që vazhdojnë të përbëjnë titujt e lajmeve dhe kanë zhvilluar një vlerësim të fortë se sa e rëndësishme është puna ime në internet, si pjesë e mbrojtjes së vlerave kolektive të lirisë dhe demokracisë". Kur u pyet se çfarë studioje në shkollë për të hyrë në këtë fushë, Dan përgjigjet se ai studioi arkeologji. "Ju nuk duhet të keni një prapavijë të thellë teknike për të qenë një analist i mirë në internet. Të jesh kurioz dhe analitik janë dy pjesët më të rëndësishme, pjesa tjetër mund të mësohet", -përfundon Dan.

Hollanda dërgon në Liban 63 specialistë dhe pajisje kërkim-shpëtimi

Hollanda ka dërguar më 6 gusht personelin e pajisjeve të kërkim-shpëtimimit dhe pajisjet e rënda në qytetin e Beirut (Liban), i cili u trondit nga shpërthimet shkatërruese në 4 gusht 2020. Personeli dhe pajisjet u dorëzuan përmes Misionit të Reagimit të Emergjencave, i organizuar nga Aftësia Strategjike Ajrore (NSPA), e mbështetur nga NSPA.

Aftësitë e kërkimit dhe shpëtimimit janë pasuria e parë dhe më e nevojshme, si dhe ekspertiza në një zonë të goditur nga katastrofa si ajo në kryeqytetin Liban, prandaj planifikimi dhe veprimi i shpejtë ishte kryesor për të marrë ekspertët në terren sa më shpejt që të jetë e mundur. Grupi i Kërkimit dhe Shpëtimimit Urban (USAR) nga Holanda, zbarkoi rreth mesnatës me kohën e Bejrutit më 5 gusht 2020, më pak se 24 orë pas kërkesës së misionit.

Ekipi, i cili përbëhet nga rreth 63 persona dhe tetë qen zbulues,




u transportua nga dy linja ajrore: një linjë ajrore tregtare dhe një prej tre avioneve Boeing Globemaster C-17 të SAC. Avioni i rëndë i SAC mbante 14 ton pajisjet e rënda të

kërkimit dhe shpëtimimit, që ekspertët hollandezë do të kenë nevojë për operacionet e tyre në Beirut.

Sipas ministrit të shëndetësisë në Liban, të paktën 137 njerëz

u vranë dhe 5000 u plagosën, në shpërthimin masiv që tronditi Bejrutit të martën e kaluar. Ekipi USAR.NL do të ndihmojë në kërkimin e të mbijetuarve. Aftësia Strategjike Airlift është një program shumëkombësh që siguron mundësinë e përdorimit të sigurimit të aftësive ajrore ushtarake për 12 vendet anëtare të saj, Bullgaria, Estonia, Finlanda, Hungaria, Lituania, Norvegjia, Polonia, Rumania, Sllovenia, Suedia, Holanda dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Agjencia e Mbështetjes dhe Prokurimit e NATO-s (NSPA) menaxhon administrimin e plotë të ciklit jetësor të tre aeroplanëve Globemaster C-17, të vendosur në Pápa Airbase, përfshirë blerjen dhe mirëmbajtjen. Ekzekutimi i misionit është përgjegjësia e vetme e krahut operacional të SAC, njësisë shumëkombëshe ushtarake, krahut të rëndë Airlift (HAW).



Duke vlerësuar lart angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së nga komunitetit egjiptian, ai kërkoi nga zëvendësministrat që të japin kontributin e tyre në fushatën informuese dhe motivuese për aplikimin e sa më shumë të rinjve nga radhët e komunitetit egjiptian dhe komunitetet e tjera duke theksuar se FSK-ja është e të gjithë qytetarëve të vendit dhe në shërbim të të gjithëve, pa dallime etnike, fetare, racore e kulturore.



MINISTRI I MBROJTJES ANTON QUNI

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni i cili shoqërohej nga zëvendësministri i Mbrojtjes Muhamedali Mergjollari, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama dhe këshilltari ushtarak i ministrit, kolonel Hamdi Pollomi, priti në takim zëvendësministrin e Infrastrukturës, Artan Berisha, zëvendësministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Bashkim Krasniqi dhe deputetin e Kuvendit të Kosovës, Veton Berisha.

Fokusi i takimit ishte në temën lidhur me procesin e integritetit të deritashëm në FSK të pjesëtarëve nga radhët e komuniteteve jo shumicë në përgjithësi dhe nga radhët e komunitetit egjiptian në veçanti, për të arriturat dhe sfidat në këtë proces si dhe për konkursin aktual për rekrutimin e ushtarëve aktivë në FSK.

Ministri Quni, në fillim i njoftoi mysafirët, me zhvillimet aktuale të Ministrisë dhe FSK-së, të arriturat e përgjithshme si dhe me objektivat për të ardhmen me theks, në angazhimet rreth procesit të integritetit të pjesëtarëve të FSK-së, nga radhët e komuniteteve jo shumicë, si imperativ i natyrshëm i vizionit të ministrisë së Mbrojtjes dhe FSK-së. Duke vlerësuar lart angazhimin e pjesëtarëve të FSK-së nga komunitetit egjiptian, ai kërkoi nga zëvendësministrat që të japin kontributin e tyre në fushatën informuese dhe motivuese për aplikimin e sa më shumë të rinjve nga radhët e komunitetit egjiptian dhe komunitetet e tjera duke theksuar se FSK-ja është e të gjithë qytetarëve të vendit dhe në shërbim të të gjithëve, pa dallime etnike, fetare, racore e kulturore.

Zëvendësministri Berisha, gjatë takimit shprehu vlerësimin e lartë për të arriturat e përgjithshme të FSK-së, si dhe me theks të veçantë u ndal rreth mundësisë së shtimit të radhëve të të rinjve nga radhët e komunitetit egjiptian dhe të komuniteteve të tjera në FSK. Ata u zotuan se do të angazhohen maksimalisht në inkurajimin e të rinjve nga radhët e komunitetit të tyre që të aplikojnë në FSK.

Ndërsa, komandanti i FSK-së, gjenerallejtënant Rrahman Rama, i njoftoi të pranishmit me konkursin si dhe interesimin e të rinjve për t'u bërë pjesë e FSK-së. Gjeneral Rama tha se jemi të interesuar për shtimin e radhëve nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve e në rastin konkret edhe nga komuniteti egjiptian, duke i inkurajuar për konkurrim sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara.

Në integrimin e FSK-së, komunitetet jo shumicë i kanë dyert e hapura

Gjeneral Rama: Jemi të interesuar për shtimin e radhëve nga pjesëtarët e të gjitha komuniteteve e në rastin konkret edhe nga komuniteti egjiptian



Kazerma "Adem Jashari" në Prishtinë

Donacione me vlerë 742 mijë USD nga Turqia

Në ambientet e kazermës "Adem Jashari" të FSK-së në Prishtinë, u mbajt ceremonia e pranimit-dorëzimit të një donacioni nga Republika e Turqisë për Forcën e Sigurisë së Kosovës, (FSK) në vlerë financiare prej 742,904.00 dollar. Ky donacion ka në përbërje: veshmbathje dhe shtretër fushor si dhe pajisje të tjera teknike. Në ceremoninë e pranimit të donacioneve ishte i pranishëm edhe komandanti i Komandës së Logjistikës të FSK-së, gjeneral brigade Naim Haziri, atasheu ushtarak i Turqisë në Kosovë, koloneli Ismail Cenkeri Ersoz dhe drejtori i Departamentit të Logjistikës në MM, kolonel Mentor Zejnullahu. Pas nënshkrimit të dokumenteve, gjenerali Naim Haziri, ka falenderuar qeverinë e Turqisë, si dhe atasheun ushtarak për përkrahjen e vazhdueshme për FSK-në.

FORCA TOKËSORE-TRAJNIMI "KOMANDO-BERETA"

FSK: Zhvillohet stërvitja fushore "Kompania në mbrojtje"

Ministri i Mbrojtjes Anton Quni së bashku me gjeneralmajor Enver Cikaqin dhe stafin e tij, ka ndjekur nga afër zhvillimin e stërvitjes fushore "Kompania në mbrojtje" të realizuar nga kompania A3 e regjimentit të tretë të forcave tokësore të FSK-së që u realizua në zonën e Qiqavicës. Në vazhdim ministri Quni vizitoi edhe pjesëtarët gjatë demonstrimit praktik të trajnimit "Komando-Bereta", që është duke u realizuar në zonën e fshatit Ceceli të komunës së Vushtrrisë. Për zhvillimin, objektivat e synuar të stërvitjes dhe trajnimit përkatës si dhe kapacitetet njerëzore e teknike të angazhuara, ministrin Quni e njoftoi komandanti i komandës së Forcave Tokësore (KFT) gjeneral Fadil Hadërgjonaj.


Nga ana e tij, ministri Quni, përgëzoi KFT-në duke vlerësuar lart angazhimin edhe në këtë kohë të përballjes me krizën pandemike, në trajnime e stërvitje të niveleve e formateve të tilla, duke treguar nivel të lartë, disiplinë e profesionalizmi për arritjen



e aftësive taktike operuese për realizimin e misionit dhe detyrave specifike të komandës së forcave tokësore dhe FSK-së në përgjithësi. "Unë kam marrë raportet e përditshme të punës dhe angazhimit tuaj dhe jam i vetëdijshëm për sfidat dhe vështirësitë nëpër të cilat keni kaluar gjatë kësaj periudhe, por me moral të lartë, kalitje fizike dhe shkathtësitë e

duhura profesionale keni arritur t'i përballoni me sukses", - tha ndër të tjera ministri Quni.

Trajnimi "Komando-Bereta" është duke vijuar dhe është trajnim në kuadër të planit vjetor të trajnimeve, sipas planit të tranzicionit për ngritjen e aftësive dhe kapaciteteve operacionale për mbrojtjen territoriale të vendit.



“Pas lajmeve për paqeruajtësit detarë të plagosur në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Liban, UNIFIL, anija e të cilit u godit nga një shpërthim në portin e Bejrutit, ne urojmë një rikuperim të shpejtë të paqeruajtësve dhe mbështetje për vendet e tyre të origjinës”.



MINISTRIA E MBROJTJES E MAQEDONISË SË VERIUT

Ushtarët e Armatës maqedonase në Liban janë të sigurtë

Tre pjesëtarë të Armatës maqedonase janë në Liban, në kuadër të Kombeve të Bashkuara, UNIFIL, të cilët kryejnë detyra në vende të sigurta jashtë Bejrutit

Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut ka informuar këto ditë, pas ngjarjeve në Liban, se pjesëtarët e Armatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Liban, UNIFIL, janë të sigurtë.

Në misionin në Liban aktualisht janë të angazhuar tre pjesëtarë të Armatës, të cilët janë vendosur dhe kryejnë detyrat e tyre në vende të sigurta jashtë Bejrutit.

“Pas lajmeve për paqeruajtësit detarë të plagosur në Misionin e Kombeve të Bashkuara në Liban, UNIFIL, anija e të cilit u godit nga një shpërthim në portin e Bejrutit, ne urojmë një rikuperim të shpejtë të paqeruajtësve dhe mbështetje për vendet e tyre të origjinës”, -thuhet në deklaratën zyrtare të Maqedonisë së Veriut. Ndërkohë Ministria e Mbrojtjes e Maqedonisë së Veriut shpreh ngushëllimet e saj më të thella për viktimat nga shpërthimi shkatërrues në Bejrut, Liban. Sipas ministrit të Shëndetësisë në Liban, të paktën 137 njerëz u vranë dhe 5000 të plagosur në shpërthimin masiv që tronditi Bejrutin të martën e kaluar.



Nëntëmbëdhjetëvjetori i vdekjes së tetë anëtarëve të Armatës

Në kujtim të pjesëtarëve të rënë, efektivëve të Armatës maqedonase, të rënë në lokalitetin Ljubotenski, delegacione të përbashkëta nga Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Ministria e Mbrojtjes, vunë lule të freskëta në përmendoret e mbrojtësve.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski dhe Ministria e Mbrojtjes, Radmila Sekerinska, drejtuan një delegacion të përbashkët nga Shtabi i Përgjithshëm dhe Ministria e Mbrojtjes, i cili vendosi një kurorë me lule të freskëta në pllakën për të përkujtuar anëtarët e rënë të forcave të sigurisë në kazermë.

Nëntëmbëdhjetëvjetori i vdekjes së tetë anëtarëve të rezervës së ushtrisë u shënuar në Ljubanci, Volkovo dhe Gjorce Petrov ku delegacionet e përbashkëta



Nderime për të rënë në kompleksin “Karpalak”

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Armatës maqedonase, gjenerallejtënant Vasko Gjurginovski ka kryesuar delegacionin e përbashkët të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore, në të cilën ishin Sekretari i Shtetit, Dragan Nikolić, të cilët vendosën një kurorë me lule të freskëta përpara pllakës përkujtimore në Karpalak, nëntëmbëdhjetë vjet nga vdekja e dhjetë anëtarëve të ushtrisë.

Me atë rast në qendër të Prilep duke hedhur një kurorë me lule të freskëta përpara kompleksit “Karpalak” u është bërë nderim anëtarëve të vdekur nga një delegacion i përbashkët nga Ministria e Mbrojtjes dhe Ushtria e Republikës së Maqedonisë Veriore.

Marko Despotovski, Nane Naumovski, Saso Kitanoski, Branko Sekuloski, Goran Minoski, Erdovan Sabanoski, Ljud u vranë në sulmin e ndodhur në rrugën Shkup-Tetovë afër fshatit Grupchin afër lokalitetit Karpalak më 8 gusht 2001. Darko Veljanoski, Pece Sekuloski dhe Vebi Rushidoski, nga përbërja rezervë e ushtrisë, nga garnizoni i Prilepit.



të Ushtrisë së Republikës së Maqedonisë Veriore dhe Ministrisë së Mbrojtjes vendosën lule të freskëta dhe u përkulën para përmendoreve.

Më 10 gusht 2001, Tome Badarovski, Goce kyankulovski, Branko Janev, Tomislav Nastevski, Marjanco Boskovski, Ivica Zlatevski, Tome Dimovski dhe Rade humbën jetën në një automjet ushtarak të ngarkuar me mineralë në rrugën afër Ljubotenski.



“Gjatë viteve të trajnimit ju demonstroi punë dhe përpjekje, vullnet dhe karakter të ngurtësuar, zotëroni teknologji të reja dhe materiale komplekse, ndërtoni aftësi drejtuese. Jam i bindur që ju do të përballeni si brez komandantësh, që jo vetëm keni zgjedhur rrugën e vështirë të një oficeri detar, por i jeni përkushtuar vetes dhe kauzës së mbrojtjes së brigjeve detare, për të mbrojtur interesat e Bullgarisë në det,”- tha Admirali Emil Eftimov në fjalimin e tij.



MINISTRI KRASSIMIR KARAKACHANOV

Vitin që vjen, një nëndetëse për marinën detare

Bisedimet janë duke u zhvilluar me Norvegjinë, ndërsa këtë vit nga kompania gjermane “Lursen” do të blihet një anije patrullimi modulare shumëfunktionale

“Klasa “Dobrudzhanski” mban këtë emër në emër të një kauze të madhe shkaku i bashkimit të tokave të fragmentuara bullgare në një shtet. Kombi duhet të ketë kauzën e tij. Një komb pa kauzë shkon në harresë dhe historia e ka vërtetuar atë. Detyra juaj kryesore sot është të mbron integritetin territorial dhe sovranitetin e atdheut tonë Bullgarisë”. Me këto fjalë, ministri i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov iu drejtua kadetëve të klasës “Dobrudzhanski” të Shkollës së Lartë Detare “N.J.Vaptsarov”, me 9 gusht, në Detit Varna. “Jam i bindur që arsimit që keni marrë në një nga shkollat më të mira detare në botë do t’ju bëjë komandantë të mirë të ardhshëm,”- tha ai, duke uruar oficerët e ardhshëm detarë në shërbimin e suksesshëm në Marinë.

Shefi i Mbrojtjes, Admirali Emil Eftimov gjithashtu mori pjesë në aktin solemn të dhënies së diplomave për arsimin e lartë të përfunduar dhe dhënien e gradës së parë të oficerëve për maturantët e Shkollës Detare. “Gjatë viteve të trajnimit ju demonstroi punë dhe përpjekje, vullnet dhe karakter të ngurtësuar, zotëroni teknologji të reja dhe materiale komplekse, ndërtoni aftësi drejtuese. Jam i bindur që ju do të përballeni si brez komandantësh, që jo vetëm keni zgjedhur rrugën e vështirë të një oficeri detar, por i jeni përkushtuar vetes dhe kauzës së mbrojtjes së brigjeve detare, për të mbrojtur interesat e Bullgarisë në det,”- tha ai në fjalimin e tij. Admirali Eftimov uroi që ata të punojnë për integrimin më të plotë të Ushtrisë Bullgare në sistemet kolektive



të sigurisë, për t’u treguar aleatëve dhe partnerëve që Bullgaria ka profesionistë me arsim të lartë të gatshëm të dëshmojnë veten në të gjitha nivelet. Këtë vit diplomat dhe shënjat e togerit iu dhane 22 kadetëve që përfunduan kursin pesëvjeçar të trajnimit në “Organizimin dhe menaxhimin e formacioneve ush-

tarake në nivelin taktik të Marinës” me specializime në “Navigacionin Detar”, “Komunikimin Detar dhe Sistemet e Radios” dhe “Makinëritë dhe mekanizmat e anijeve”. Gjithsej 10 ishin studentët të shkëlqyer të “Dobrudzhanski”.

Dhënia e diplomave për oficeret

e parë, të Shkollës Detare përkoji me kulminacionin e festimeve të festës së Marinës. Këtë vit, me rastin e 141-vjetorit të krijimit të Marinës dhe 50-vjetorit të krijimit të Njësisë së Inteligjencës Speciale Detare, ushtarakët e marinës demonstrian aftësi luftarake. Demonstrimi dinamik përfshinte drejtimin e anijeve me shpejtësi, zhytjet, grupin sulmues ajror dhe anije me dy ekipe snajperësh nga Skuadra e Inteligjencës Speciale Detare, helikopterët nga baza ajrore Detare Chaika dhe një varkë nga Varna. Ushtarët demonstrian aftësitë e tyre në kryerjen e detyrave tipike të një operacioni antiterror. Ministri

i Mbrojtjes Krassimir Karakachanov njoftoi në përgjigje të pyetjeve gazetareske se ai pret që kontrata për blerjen e një anije patrullimi modulare shumëfunktionale për Marinën të nënshkruhet në tetor të këtij viti. Tani po zhvillohen bisedime me fituesin e procedurës, kompaninë gjermane “Lursen”. Ministri Karakachanov gjithashtu theksoi se anija do të ndërtohet në Bullgari. “Ekzistojnë dy mundësi për blerjen e një nëndetëseje për Marinën. Bisedimet janë duke u zhvilluar me Norvegjinë dhe një vend tjetër evropian dhe shpresoj që kjo çështje të zgjidhet në vitet e ardhshme,”- tha ministri Karakachanov.

Stërvitja bullgare-amerikane “Verë Thrakiane-2020”

Në Bullgari do të zhvillohet stërvitja e përbashkët bullgare-amerikane “Verë Thrakiane-2020”, i cili do të zgjasë deri më 28 gusht 2020 dhe do të mbahet në zonat e Aeroportit Plovdiv, formacioni ushtarak 32 040-Krumovo, Aeroporti Cheshnegirovo, seksioni rrugor Fshati Poroyna - fshat Lenovo dhe në zona të ndara përkohësisht të hapësirës ajrore të Republikës së Bullgarisë. Marrin pjesë deri në 650 ushtarakë nga Forca Ajrore Bullgare, Komanda e Operacioneve Speciale të Përbashkëta, Marina, Forcat Tokësore dhe strukturat nën komandën e drejtpërdrejtë të Sekretarit të Mbrojtjes dhe deri në 150 ushtarakë nga Forcat Ajrore të SHBA. Do të përdoren pajisjet e raketave të aviacionit dhe anti-aeroplanit të Forcave Ajrore Bullgare dhe Amerikane, që përfshijn deri në 3 avionë transporti S-130J, 2 avionë transporti S-27J, 2 helikopterë AS-532AL/Mi-17, një aeroplan MiG-29 dhe një sistemi raketor anti-ajror 2K12 “Kub”.

Një pjesë e objektivave të përgatitjes janë: përpunimi i procedurave për zbatimin e elementeve që lidhen me përdorimin luftarak të avionëve të transportit; rritja e përgatitjes teorike dhe taktike-speciale të llogaritjeve luftarake nga trupat e raketave anti-aeroplan përmirësimi i procedurave në Forcën Ajrore për logjistikë dhe mbështetje gjithëpërfshirëse si një vend pritës, si dhe aftësitë e kontrolluesve të trafikut ajror; rritja e ndërveprimit midis ekipazheve në forcat operacionale ndërkombëtare.

Nga 11 deri në 21 gusht, pjesëmarrësit në “Verë Thrakiane - 2020” do të rritin trajnimin e tyre për kryerjen e fluturimeve taktike me lartësi të ulët në grupe të përziera, transportin e trupave dhe ngarkesave, ajrin taktik të ajrit, zbulimin vizual të ajrit, fluturimet në grup, ulje në lartësi të mesme dhe të ulët, hedhje me parashutë, si dhe në zbatimin e detyrave të mbulimit të raketave anti-ajrore të vendeve strategjike të infrastrukturës kritike të vendit, manovrim luftarak për të kapërcyer mbrojtjen ajrore, duke përfshirë avionët tokësorë dhe luftarakë, përgjimet taktike në shënjestrën me shpejtësi të ulët të lartësi të ulët, evakuim mjekësor, etj. Kreu i stërvitjes së përbashkët bullgare-amerikan “Verë Thrakiane- 2020” është koloneli Yuri Lukanov-Nëndrejtori i Shefit të Shtabit të Forcave Ajrore të Republikës së Bullgarisë.

STËRVITJA “NOVO SELO”

Admirali Eftimov takohet me gjeneralin amerikan James McConville


Shefi i Mbrojtjes, Admirali Emil Eftimov, zhvilloi një takim me 8 gusht, me Shefin e Shtabit të Ushtrisë amerikane, gjeneralin James McConville, në terrenin e stërvitjes Novo Selo.

Në takim, Admiral Eftimov dhe Gjeneral McConville diskutuan çështje që lidhen me trajnimin e ushtarakëve bullgarë dhe amerikanë, si dhe ndikimin e krizës COVID 19 në intensite-

tin e saj. Bisedimet u përqëndruan në përdorimin e lehtësirave të përbashkëta dhe zhvillimin dhe modernizimin e tyre në të ardhmen, si dhe perspektivat për bashkëpunim midis forcave tokësore të të dy vendeve.

Admirali Eftimov dhe Gjeneral McConville vlerësuan arritjet e deritanishme dhe komunikimin e mirë kur morën pjesë në ngjarje të përbashkëta. Në takim mori pjesë edhe

Ambasadori amerikan në Bullgari Heroi Mustafa, Ambasadori për Punët e Jashtme dhe Këshilltari i Gjeneralit McConville Laura Doe, Komandanti i Ushtrisë Amerikane në Evropë Gjeneral Lejtënant Christopher Cavoli, Komandanti i Komandës së 21-të të Mbështetjes, Gjeneral Major Mohan. Në anën bullgare, mori pjesë Komandanti i Forcave Tokësore, gjeneralmajor Mihail Popov.



Në skenarin e stërvitjes praktike të aplikuar një pjesë e forcave kroate simuluan forcat kundërshtare që kërkonin pilotët e rënë. Instruktorët e Forcave të Armatosura Kroate të Mbijetimit, Evazionit, Rezistencës dhe Arratisjes nga zona e rrezikshme ishin angazhuar si këshilltarë evazioni për pilotët e 555 të Skuadriljes luftarake.



FORCAT E AJRORE KROATE-FORCAT AJRORE TË SHBA -së

Zhvillohet stërvitja ajrore në qendrën e trajnimit "Eugen Kvaternik"

Forcat e Ajrore Kroate janë anëtare e Komandës së Forcave Speciale dhe të Regjimentit të Inteligjencës të Forcave Ajrore të SHBA-së

Stërvitjet e nivelit ndërkombëtar të këtij lloji ofrojnë një mundësi të shkëlqyeshme për të rivendosur ndërveprimin dhe zhvillimin e aftësive reciproke përmes shkëmbimit të përvojave dhe mësimave të marra. Forcat e Armatosura Kroate (anëtarët e Komandës së Forcave Speciale dhe të Regjimentit të Inteligjencës) dhe Forcave Ajrore të SHBA (RWS 31-të Fighter) 56 RQS, 555 FS dhe 510 FS zhvilluan një program të përbashkët stërvitor në Rangin e Trajnimit "Eugen Kvaternik" afër Slunj. (Slunj është një qytet në pjesën malore të Kroacisë Qendrore, e vendosur përgjatë rrugës së rëndësishme Veri-Jug për në detin Adriatik midis Karlovac dhe Parkut Kombëtar të Plitvice Lakes, në takimi i lumenjve Korana dhe Slunjčica. Administrativisht, qyteti është pjesë e Qarkut Karlovac).

Praktika përmbante kërkimin ajror të pilotëve të ulur duke përdorur një aeroplan të specializuar S&R HC-130J Combat King dhe një operacion shpëtimi duke përdorur helikopterin HH-60G Pave Hawk, dhe gjithashtu praktikën e kërkimit luftarak dhe shpëtimit të ekuipazheve ajrore dhe mbështetjes së ngushtë të ajrit me qitje të hapur.



Në skenarin e stërvitjes praktike të aplikuar një pjesë e forcave kroate simuluan forcat kundërshtare që kërkonin pilotët e rënë. Instruktorët e Forcave të Armatosura Kroate të Mbijetimit, Evazionit, Rezistencës dhe Arratisjes nga zona e rrezikshme ishin angazhuar si këshilltarë

evazioni për pilotët e 555 të Skuadriljes luftarake.

Gjatë operacionit të simuluar të kërkimit dhe shpëtimit luftarak, ekipet e kontrolluesve të sulmeve të terminalit të përbashkët (JTAC) të Forcave të Armatosura Kroate ofruan mbështetje të ngushtë ajrore për dy helikopterët HH-

60G dhe katër avionëve F-16CM.

Helikopterët HH-60G angazhuan caqe tokësore me makina 12,7 x 99 mm GAU-18, ndërsa F-16CM angazhuan objektiva me armë Vulcan 20-mm M-61.

Stërvitja ishte një mundësi për ekuipazhet e ajrit që ato të praktikojnë

procedurat dhe saktësimin e angazhimit në një terren të panjohur. Specifikimi i mbështetjes së afërt ajrore konsiston në bashkëveprimin e dimensioneve horizontale dhe vertikale dhe në sfidën e integritit të çdo sulmi ajror me zjarret dhe manovrën e njësisve në tokë.

Aktiviteti i ngushtë i stërvitjes ajrore shërbeu si një vlerësim i rregullt i instruktorëve JTAC dhe JTAC nga një JTAC i kualifikuar, i cili ishte një pjesë e mirëmbajtjes së rregullt të kualifikimit të Forcave të Armatosura JTAC të KT sipas standardeve të NATO-s. Në mënyrë që të ruajnë kualifikimin e tyre, secila JTAC duhet të kryejë një numër të caktuar të stërvitjeve të ngushta të kontrollit të mbështetjes së ajrit të një lloji të përcaktuar për të qenë në gjendje të mbështesin një njësi manovrimi të cilit i është caktuar. Stërvitja e trajnimit ndërkombëtar të këtij lloji ofron një mundësi të shkëlqyeshme për të rivendosur ndërveprimin dhe zhvillimin e aftësive reciproke përmes shkëmbimit të përvojave dhe mësimave të marra.

Pas misionit 6 mujor, 188 efektivët kroatë kthehen nga Lituania

Në kazemat e Brigadës "Gardijske Pauci" në Knin u zhvillua ceremonia zyrtare e kthimit nga Lituania të kontingjentit kroat, i inkuadruar në kuadër të NATO-s. Në ceremoni morën pjesë Komandanti i Ushtrisë Kroate, Gjeneral Major Boris Šeriš, Komandanti i Brigadës së Mekanizuar të Gardës, kolonel Dražen Ressler dhe përfaqësues nga Shoqata e Veteranëve të Brigadës të Gardave.

Gjeneral Major Šeriš uroi anëtarët e kontingjentit kroat në Lituani për arritjet e tyre gjatë angazhimit në një mision të rëndësishëm dhe të kërkuar ndërkombëtar, dhe theksoi se detyrat e tyre kërkonin profesionalizëm të duhur, përshtatje ndaj një mjedisi ndërkombëtar, përpjekje të jashtëzakonshme dhe kontribut nga secili anëtar i HRVCON, dhe që uniteti, motivimi i qartë dhe udhëheqja cilësore rezultuan në një gatishmëri të lartë dhe trajnim dhe përfaqësim dinjitoz të Ushtrisë Kroate dhe Forcave të Armatosura Kroate. Gjeneral Šeriš vlerësoi anëtarët e HRVCON-it të dytë për profesionalizmin e shfaqur në rrethanat kritike të epidemisë dhe uruar anëtarët dhe duke shprehur mirënjohje për familjet e tyre.

Kurse kolonel Ressler mirëpriti dhe uroi anëtarët

e HRVCON të II-të për arritjen e shkëlqyeshme dhe prezantimin dinjitoz të Forcave të Armatosura Kroate dhe të Republikës së Kroacisë në një mjedis ndërkombëtar. Kolonel Ressler tha gjithashtu se detyrat e caktuara kërkonin motiv të lartë, përpjekje dhe përgjegjësi të secilit anëtar të Kontingjentit.

Komandanti i HRVCON-it të 2-të, Kapiteni Robert Bajan tha se anëtarët e Kontingjentit, me shumë motivim, trajnim dhe përgatitje, përmbushën të gjitha detyrat që u ishin caktuar atyre gjatë misionit 6-mujor të Pranisë së Përpëruar në Lituani, dhe se ata vendosën bashkëpunim me forcat e armatosura e disa vendeve të NATO-s, veçanërisht me Forcat e Armatosura të Norvegjisë, Holandës, me Kombin e Liderit (Gjermani) dhe me Ushtrinë Amerikane.

Grupi i betejës i udhëhequr nga Gjermania për Pranimin e Zgjeruar Përpara në Lituani ishte i përbërë nga Kontingjenti Kroat me 188 anëtarë, kryesisht forcat e kompanisë së mekanizuar të Batalionit të 3-të të Mekanizuar "Pauci" të Brigadës së Mekanizuar të Gardave të Ushtrisë Kroate, dhe të armatosur forcat e Holandës, Norvegjisë, Belgjikës, Luksemburgut, Francës dhe Lituaniës si kombi pritës.



1925-2020

95 vjetori i Flotës Detare shqiptare

Forca Detare Shqiptare ka për qëllim sigurimin dhe ruajtjen e sovranitetit të hapësirës detare të Shqipërisë dhe zbatimin e ushtrimit të ligjshmërisë në det

Me shpalljen e pavarësisë më 28 nëntor 1912, u bënë përpjekjet e para për organizimin e FD shqiptare nga qeveria e Ismail Qemalit, por fillimi i Luftes se Pare Boterore e ndërpreu këtë angazhim.

Në vitin 1925, organizimi i ushtrisë synoi të bëhej mbi bazën e statusit të Shqipërisë hartuar më 07.03.1925. Mbi bazën e këtij statusi u krijua Komanda e Përgjithshme e Fuqive Ushtarake. Më 25 dhjetor 1925, mbërrinjë nga Italia dy anije 190 tonësh, të cilat u emërtuan me emrat domethënës "Shqipëria" dhe "Skenderbeg". Këto anije u pajisën me efektiva marinarësh duke kryer detyra në interes të luftës kundër kontrabandës në brigjet shqiptare.

Më 1928, u krijua Komanda e Marinës dhe më konkretisht më 24.06.1928, kur u mbledhën rekrutët e parë për këtë armë. Më 1934, u blenë po nga Italia edhe dy anije të tjera të lehta, të cilat u emërtuan "Saranda" dhe "Durrësi". Gjatë periudhës së Luftes se Dytë Boterore pothuajse u shkatërrua gjithçka nga këto anije. Çlirimi i Shqipërisë e gjeti Flotën Shqiptare në gjendje të mjerueshme me pothuajse të gjitha anijet e mbytura në portet e bregdetit shqiptar. Në prill 1945, u krijua Kantieri Detar Durrës për riparimin e varkave ekzistuese, nxjerrjen e anijeve të mbytura gjatë luftës dhe përgatitjen e tyre për qëllime ushtarake. Më 15 gusht 1945, u bë përrurimi i hedhjes në ujë të dy motoskafeve trofe, me numër MS 10 dhe MS 12. Këto motoskafe u armatosën me mitraloz të lehtë dhe filluan patrullimin për ruajtjen e ujërave bregdetare në Vlorë e Sarandë.

Në këtë periudhë u punua me një vizion të qartë për zhvillimin dhe perspektivën e Forcave Detare, duke shfrytëzuar edhe konjunkturën politike të kohës. Kështu mund të përmendim vitet '53-'54, që shënuan fillimin e një etape të re zhvillimi të FD me pajisjen e tyre me silurhedhëse e më vonë me minaheqëse, gjuajtës detar dhe anije ndihmuese të llojeve të ndryshme. Më 14 shkurt 1954, u krijua Skuadrilja e Katrave Silurues me vendbazim në ishullin e Sazanit, kjo shënon edhe fillimin e një stadi të ri zhvillimi të FD. Zhvillimi e modernizimi i flotës filloi me ritme të shpejta, sidomos pas vitit 1957. Më 21 shtator 1958, filloi aktivitetin një nga njësitë më speciale e më të rëndësishme të FD shqiptare, Njësia e Nendeteseve, në përbërje të së cilës ishin 4 nëndetese të prodhuara në ish-Bashkimi Sovjetik.

Në gusht të vitit 1961, u hap Shkollat e Marines në Vlorë e cila me pas u quajt Shkollat e Trupës e Detarise, e cila ka luajtur një rol të madh në përgatitjen dhe furnizimin e Flotes Luftarake Detare me kuadro oficerë. Periudha e viteve 1961-1980, shënoi zhvillimin e mëtejshëm të Forcave Detare, krijimin e disa reparteve të KS, kompletimin me anije luftarake moderne të kohës. U krijua Shërbimi Hidrografik, si organizim sigurimi lundrimordetar e të



veprimeve luftarake, i cili përgatiti e ngriti një varg faro-fenerësh në gjithë bregdetin, u modernizuan mjaft pika sinjal-vrojtuese dhe u pajisën me një rrjet të gjerë radiolokatorësh. Periudha e viteve 1980-1980, mund të konsiderohet si periudha e vijueshmërisë së lundrimeve, mbijetesës, drejtimin dhe sigurimin e gatishmërisë teknike të anijeve mbiujëse e nënujësë. Një kontribut të madh në këtë drejtim ka dhënë edhe Kantieri Detar i Riparimit të Anijeve në Pashaliman.

Mbas viteve '90, për FD shtrohej detyra e ristrukturimit, rikonceptimit të reparteve të saj për një integrim të natyrshëm me strukturat e NATO dhe BEP-it. Në këtë periudhë vlen për t'u theksuar, mbështetja që dhanë kuadrot dhe efektivat e FD për proceset demokratike në vend, fal pjekurisë politike, shpirtit atdhetar e demokrat. U rrit në mënyrë të ndjeshme, bashkëpunimi me flotat e vendeve perëndimore e veçanërisht me ato të NATO, ku u zhvilluan me sukses mjaft stërvitje të përbashkëta, si "SAREX-1", "SAREX-2", "MAREX-1", "MAREX-2" etj, në të cilat kuadrot tanë treguan një nivel të lartë profesional, nivel i cili u vlerësua nga të huajt.

Ngjarjet tronditëse të marsit 1997, shkaktuan në repartet e FD dëme shumë të mëdha. Gjysma e dytë e vitit 1997 dhe viti 1998, shënon një etape ringritjeje dhe riorganizimi të reparteve të FD pas shkatërrimit total. Pas një pune këmbëngulëse dhe përkushtimi maksimal të kuadrove e efektiveve

të FD, u bë e mundur ringritja dhe funksionimi i Distrikteve Detare të Durrësit e Vlorës, si dhe Bazat Ndihmuese, Sarandë e Shengjin. Vlen për t'u përmendur në këtë proces ringritjeje, ndihma e partnerëve tanë perëndimorë si: SHBA, Italia, Turqia, Greqia, Gjermania, etj. Mbas vitit 1997, u synua ringritja e FD me anije të cilat gjatë ngjarjeve të marsit u strehuan në Itali, dhe që fal marrëveshjes së përbashkët të të dy shteteve, pas riparimit u rikthyen në Shqipëri. Në mars të vitit 1998, me ndihmën e qeverisë së SHBA, FD u pajisën me 5 motovodeta, të cilat u bënë protagonistet e operacioneve SAR në vitet e ardhshme. Më 1998, si rezultat i kohës së gjatë të përdorimit dolën jashtë strukturave luftarake të FD, të 4 nëndetese e saj pas një veprimtarie 40-vjeçare.

Në vitin 2002, me kontributin e qeverisë italiane pas miratimit të ligjit të Rojës Bregdetare shqiptare, nr. 8875 datë. 04.04.2002, FD u pajisën dhe me 6 motovodeta nga Italia, të cilat së bashku me anijet amerikane u futën në strukturat e Rojës Bregdetare. Në gusht 2002, 14 anije të FD morën pjesë në operacionin e gjerë antitrafik "PUNA", në bashkëpunim me organet e rendit, antiktrabandës, peshkimit, etj, i cili u realizua me sukses dhe bëri të mundur bllokimin e këtij trafiku.

Më 12 shtator 2005, në rajonin e Gjirit të Vlorës u zhvillua stërvitja më e madhe e përbashkët detare "Cooperative Engagement" me pjesëmarrjen e flotave të 14 vendeve të ndryshme të

botës. Forca Detare morën pjesë me 19 anije të tipeve të ndryshme. Në shkurt 2007, filloi puna për zbatimin e Sistemit të integruar të Vezhgimit, projekt që u zbatua nga firma prestigjioze "Lockheed-Martin".

Në qershor të vitit 2007, Forcat Detare kaluan në strukturën e re, Brigadë Detare me dy Flotilje (FDV E FDJ) dhe një Batalion Logjistik. Gjatë këtij viti, nga efektivat e FD u ndërmorën mbi 10 operacione kërkimshpëtimi dhe disa stërvitje brenda e jashtë vendit në bashkëpunim me flotat partnere të NATO. Në nëntor 2007, u nënshkrua marrëveshja me Holandë, (Kantieri "DAMEN SHIPYARD"), për pajisjen e FD me 4 anije patrulluese. Më 4 dhjetor 2007, në paradën e zhvilluar me rastin e përvjetorit të krijimit të FA Shqiptare, FD u përfaqësua denjësisht me 2 kuadrate, (një me kuadro, një me detarë). Më datë 07.02.2008, në Ministrinë e Mbrojtjes u zhvillua ceremonia e nënshkrimit të Memorandumit Taktik të Mirëkuptimit për pjesëmarrjen e Shqipërisë në operacionin "Active Endeavour", (TMOU). Ky memorandum përcakton detyrat dhe mënyrat e pjesëmarrjes së vendit tonë në operacionet "Active Endeavour", në kuadrin e NATO, që përfshin kryesisht shkëmbimin reciprok të informacionit mbi situatën detare në zonat gjeografike ku shtrihet ky operacion, komunikimet, pajisjet e nevojshme si dhe bashkëveprimin e mëtejshëm midis palëve në këto fusha. Nga data 1-5 mars 2028, 5 anije të Grupit të 2-të

Detar të NATO (SNMG2), me qëndër në Napoli zhvilluan një vizitë portuale në vendin tonë.

Qëllimi i kësaj vizite ishte forcimi i bashkëpunimit dhe rritja e mirëkuptimit midis vendit tonë dhe strukturave të NATO. Grupi i 2-të i anijeve përbëhet nga: TCG SALIHREIS TCG SALIHREIS (Turqi), anije flamurtare, HMS SOMERSET (Britani e Madhe Britani), ITS EURO (Itali), FGS NIEDER-SACHSEN (Gjermani) dhe HS HYDRA (Greqi). Misioni i Grupit të 2-të të anijeve është kryerja e operacioneve të ndryshme në Detin Mesdhe. Gjatë kësaj vizite, ekuipazhet e anijeve të NATO vizituan vende të rëndësishme historike dhe kulturore në Durrës, Krujë, Berat, etj, si dhe zhvilluan aktivitete sportive me repartet e BrD dhe strukturat e Policisë së Sigurisë Portuale. Në datën 5 shtator 2008, në Kalatën Nr. 5 të Portit të Durrësit u zhvillua ceremonia e përrurimit të anijes "Iliria" (P-131), e cila mbërriti në Shqipëri në kuadër të zbatimit të kontratës me Kompaninë Holandeze "DAMES SHIPYARD". Në këtë ceremoni morën pjesë autoritete të larta politike dhe ushtarake, komandantë të reparteve të ndryshme, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, shefa të Misioneve të Huaja ushtarake në vend, etj.

Mbas një pune njëvjeçare, në muajin nëntor 2008, u zhvilluan provat finale për marrjen në dorëzim të Sistemit të Integruar të Vezhgimit Detar (SIVHD), të instaluar nga specialistët e kompanisë "Lockheed Martin".

Detyrat e Forcave Detare janë: të sigurojë në çdo kohë, aftësi operacionale dhe gatishmëri luftarake, me kapacitetet e nevojshme për t'ju përgjigjur kërcënimeve dhe rreziqeve në realizimin e misionit kushtetues; të sigurojë dhe të mbrojnë hapësirën detare territoriale dhe bregdetin shqiptar, duke kryer operacione të përbashkëta me strukturat e FA dhe të NATO në drejtimet e kërcënuara; monitorimi dhe kontrolli i trafikut detar në ujërat territoriale dhe vijën bregdetare; organizimi dhe realizimi i operacioneve të kërkim-shpëtimi (SAR) dhe operacioneve humanitare në ndihmë të popullsisë në bashkëpunim me strukturat e FA; të ruajë dhe të mbrojnë mjedisin detar për zbatimin e ligjshmërisë në det; sigurimi i kushteve hidrolundrimore dhe sinjalistikës detare për një lundrim të parrezikshëm në hapësirën detare të RSH; të ruajë dhe mbrojnë mjedisin detar nga ndotjet dhe të ushtrojë kontrollin e kalimit të paligjshëm të mallrave dhe njerëzve dhe të marrë pjesë në përbalimin e rreziqeve asimetrike të terrorizmit, krimin të organizuar në bashkëveprim me organizmat shtetërore të specializuara në këtë drejtim.

75-vjetori i bombardimit të Hiroshimës

Hiroshima, bombardimi i parë atomik në botë

Bombardimi atomik nga amerikanët në orën 8:15, më 6 gusht të vitit 1945, ka lënë të vdekur 140,000 persona. Por prapë, Hiroshima është ringjalluar dhe është kthyer në simbol të paqes

Të enjten e javës që kaloi, më 6 gusht 2020, në Hiroshima kanë rënë këmbanat ndërsa vendi shënoi 75-vjetorin e bombardimit të parë atomik në botë, ndonëse ceremonitë janë organizuar për më pak njerëz për shkak të pandemisë së koronavirusit. Kryeministri japonez, Shinzo Abe ka qenë pjesë e ceremonisë, mirëpo vizitorët e huaj kanë qenë të paktë. Hyrja në Parkun e Paqes në këtë qytet është kufizuar dhe pothuajse vetëm të mbijetuarit dhe familjet e tyre kanë mundur të jenë pjesë e ceremonisë përkujtimore.

Kryebashkiaku i qytetit, Kazumi Matsui tha se rëndësia e bombardimit që ka lënë të vdekur 140,000 persona, i ka shtyrë ata të mbajnë ceremoninë pavarësisht pandemisë.

“Më 6 gusht të vitit 1945, një bombë e vetme atomike ka shkatërruar qytetin tonë. Në mesin e thashethemeve që kanë qarkulluar atë kohë kanë qenë dhe ato se ‘asgjë nuk do të rritet këtu për 75 vjet’”, - ka thënë Matsui.

“Por prapë, Hiroshima është ringjalluar dhe është kthyer në simbol të paqes”.

Në orën 8:15 të 6 gushtit të vitit 1945, një avion ushtarak amerikan hodhi në qytetin japonez bombën, duke shkatërruar qytetin me një popullsi prej rreth 350,000 banorësh. Mijëra persona kanë vdekur më vonë për shkak të plagëve dhe sëmundjeve të lidhura me rrezatim. Bombardimi i Hiroshimës u shoqërua tre ditë më vonë nga hedhja e bombës në Nagasaki, duke lënë të vdekur 75,000 persona. Japonia u dorëzua gjashtë ditë më vonë, duke i dhënë kështu fund Luftës së Dytë Botërore.

Hedhja e bombës atomike mbi Hiroshima dhe Nagasaki ishte sulmi nuklear nga ana e SHBA-ve, me në krye presidentin Harry S. Truman kundër Perandorisë Japoneze gjatë Luftes së Dytë Botërore. Më 6 gusht, bombarduesi B-29 Superfortress, i emëruar do të hidhte bombën atomike “Little Boy” (Djali i vogël) mbi Hiroshima me pasojë shkatërrimin e qytetit nga impakti i bombës. Hedhja e bombës atomike mbi Hiroshima, do të pasohej me hedhjen e bombës atomike “Fat Man” (Burri i shendoshe) në Nagasaki, më 9 gusht të po atij viti.

Bomba atomike do të shkaktoje vdekjen e shumë personave (kryesisht civilë). Është pak e vështirë të jepet një shifër e saktë për viktimat e Hiroshimës duke marrë në shqyrtim të vdekurit nga impakti dhe të vdekurit nga rrezatimi. Sipas disa shënimeve zyrtare, rezultojnë 140 000 të vdekur në Hiroshima (gjatë dhe pas impaktit). Ndërsa për Nagasakin numërohen rreth 74 000 viktimat. Nga të



dy qytetet me një numër vdekjesh prej 210 000 jetësh, popullsia civile do të ishte ajo që do të vuante më shumë shpërthimet e dy bombave atomike.

Sot hedhja e bombës atomike në Hiroshima si edhe në Nagasaki, debatohet gjerë nga të dy palët në fjalë (SHBA dhe Japonia) dhe ndonjëherë debatohet edhe nga palët e tjera. Ky lloj sulmi ishte sulmi i parë nuklear në botë dhe shpërthimi i kësaj bombe do të përshpejtonte dorëzimin e Japonisë Imperialiste, duke i dhënë fund luftës. Japonia do të dorëzohej zyrtarisht më 2 shtator 1945, duke i dhënë fund luftimeve në glob. Por ndërkohë që njëra palë e shikon këtë gjest (hedhjen e një bombe atomike) si të domosdoshme për kohën (pikëpamja e SHBA), pala tjetër (pikëpamja e Japonisë) e shikon si një krim të shëmtuar kundrejt njerëzimit. Në SHBA, debati merr një formë krejt tjetër dhe kjo palë insiston se hedhja e bombës atomike, i dha fund luftimeve shumë më shpejtë se sa do të mund të përfundonte në kushte normale. Në kushte normale, hamendësohet se lufta do të shkaktoje një numër shumë më të madh viktimash nga të dy palët. Operacioni Downfall parashikonte pushtimin e brigjeve japoneze duke rrezikuar një “Normandi tjetër” për amerikanët. Pala

japoneze ndërkohë, pretendon se hedhja e bombës atomike, ishte një veprim i shëmtuar dhe aspak i domosdoshëm; një sulm ky që goditi kryesisht civilët. Për shembull më dhjetor 2006, një kompetent i partisë Demokrat Liberale në Japoni, Shoichi Nakagawa, do të deklaronte se hedhja e bombës atomike nga ana e SHBA, ishte një krim. Kjo deklaratë e Shoichit erdhi mbasi ai kishte vizituar një nga muzetë përkujtimorë të bombës atomike në Nagasaki. Të dielave, pak më vonë nga ky koment, Kjodo News Agency dhe gazeta si Nihon Keizai e vlerësuan këtë koment, duke thënë përfundimisht se hedhja e bombës atomike ishte një krim ndaj njerëzimit. Megjithatë, Japonia nga ana e saj akoma duhet të mbajë përgjegjësi të plotë për krimet e saj të luftës si masakra e Nanjing, tmerret e kryera nga njësia famekeqe 731, vrasja dhe keqtrajtimi i robërve të luftës, e të tjerë.

Siç përmendet më lartë, debati vazhdon edhe sot e kësaj dite. Ajo që dihet me siguri është që Japonia Imperialiste do të dorëzohej më 15 gusht 1945, për të nënshkruar përfundimisht dorëzimin e saj më 2 shtator, që është edhe data zyrtare e fundit të luftës së dytë botërore. Përfundimisht, hedhja e bombës atomike në Hiroshima dhe Nagasaki, nuk është cilësuar zyrtarisht si krim lufte..

Teleskopi VLT i Observatorit Jugor European (ESO) në Kili

Fotografohet në hapësirë një “flutur” kozmike

Engjashme me një flutur, me strukturën e saj simetrike, ngjyrat e bukura dhe modelet e ndërlikuara, ajo duket se noton dhe përplaslet në hapësirë, por në realitet është një “mjegullnajë” planetare, një fluskë gazi e njohur si NGC 2899.

Ajo është fotografuar teleskopi VLT i Observatorit Jugor European (ESO) në Kili dhe për herë të parë në detaje të papara. “Mjegullnaja”, e cila ndodhet midis 3 000 dhe 6 500 vite dritë larg në yjësine jugore të Velës, ka dy yje qendrore, që besohet të jenë në origjinën e pamjes së saj pothuajse simetrike. Kur ylli i parë arriti në fund të “jetës” së tij dhe “dëboi” shtresat e tij të jashtme, ylli i dytë filloi të ndërhynte në rrjedhën e gazit duke formuar kështu formën e fluturës. Vetëm rreth 10-20% e mjegullnajave planetare tregojnë këtë lloj forme bipolar.

NASA në Mars në kërkim të jetës antike

Anija amerikane 2,5 miliardë USD e quajtur “Perseverance”

NASA ishte e vendosur dhe ka nisur me 30 korrik roverin e saj më të ri në Mars, në një mision ambicioz për të kërkuar shenja të jetës antike marsiane. Agjencia hapësinore amerikane ka nisur anijen 2,5 miliardë dollarëshe, të quajtur “Perseverance”, në një raketë “Atlas V” nga Cape Canaveral, në Florida.

Roveri robotic-ai më kompleksi i NASA-s-është krijuar për të kërkuar për shenja të jetës antike të mikrobeve në Mars, për të studiuar klimën dhe gjeologjinë e planetit, për të mbledhur mostra nga shkëmbinjët dhe për të hapur rrugën për eksplorimin njerëzor të Planetit të Kuq.

“Kjo është hera e parë në histori ku ne do të shkojmë në Mars me një mision të qartë për të gjetur jetën një botë tjetër në Mars”, -tha administratori i NASA-s, Jim Bridenstine. Ky është misioni i tretë në Mars për këtë vit, pasi Kina dhe Emiratet e Bashkuara Arabe nisën anijet e tyre kozmike muajin që kaloi.

SpaceX lëshon dhjetëra satelitë të rinj për internetin

Kompania amerikane e hapësirës ajrore, SpaceX ka dërguar dje edhe 57 satelitë të tjerë në hapësirë për një rrjet sa më global interneti. Ata u dërguan në hapësirë nga Cape Canaveral, Florida. “Satelitët e rinj janë të pajisur me një lloj të ri hapjeje në mënyrë që ata të mos shkëlqejnë aq shumë sa të mëparshmit”, - tha Sven Melchert, kryetari i Shoqatës së Miqve të Yjeve.

“Kjo është për shkak të një marrëveshjeje me astronomët, sepse pa këtë hapje, satelitët do të zvogëlonin në mënyrë të konsiderueshme shumë vëzhgime astronomike në të ardhmen”, - tha ai. Satelitët, të cilët peshojnë mbi 200 kilogramë secili, duhet të marrin të dhëna nga stacionet tokësore dhe ta transmetojnë mes tyre duke përdorur rrezet lazer. Ata do të fluturojnë në orbita relativisht të ulëta.



Përfundon Kursi XVI "Komando"

Të premten e javës që kaloi më 7 gusht 2020, në mjediset e batalionit Komando, u zhvillua ceremonia e përfundimit të Kursit XVI "Komando". Në këtë ceremoni morën pjesë: komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, komandanti i Qendrës Stërvitore kolonel David Rroku, komandanti i batalionit Komando nënkolonel Edmond Doda, komandantë të reparteve të Forcës Tokësore si dhe familjarë të kursantëve. Ky aktivitet, ndryshe nga herët e tjera, nisi me demonstrime stërvitore, ku të ftuarit në këtë ceremoni patën rastin të shihnin nga afër veprimet e trupave "Komando" në disa stacione si: kalimi i brezit të kalitjes, mbijetesa, përgatitje fizike me elementët e rinj sipas modelit amerikan, hyrje në godinë, çlirim pengjesh dhe qitje në nivel skuadre.

Më pas, fjalën e rastit në këtë ceremoninë e mori komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Albert Mullai, i cili iu shprehu kursantëve urimet më të mira: "...Sot tha ai, është dita që ju kurorëzoni përpjekjet tuaja 12 javore duke u stërvitur në kushte ekstreme moti dhe terreni, ditën dhe natën duke shpalosur karakterin dhe shpirtin luftarak e të pamposhtur ndaj çdo situatë në të cilën jeni përballur.

Trupat Komando kanë një histori të gjatë operacionale si brenda dhe jashtë vendit, ku për më shumë se 25 vjet kanë dëshmuar histori sukcesi. Ata kanë kontribuar jo vetëm në luftën kundër terrorizmit, por edhe në shërbim të paqes dhe sigurisë, krah për krah me Aleancën në Irak dhe Afganistan" - tha ndër të tjera gjeneral Mullai.

Komandanti i Forcës Tokësore, falënderoi për punën e shkëlqyer drejtuesit e kursit kapiten Skrapalliu dhe kapiten Feti të cilët nën lidërshpin e tyre dhe me punën e palodhur të instruktorëve realizuan me sukses Kursin XVI "Komando". Më pas, Zall-Herri gjëmoi sërish nga betimi i trupave "Komando", një betim i cili bën krenar jo vetëm këto trupa, por të gjithë Forcën Tokësore. Ceremonia u mbyll me vendosjen e beretave dhe ndarjen e certifikatave. Ministrja e Mbrojtjes, Olta Xhaçka ka lajmëruar se ushtarët e rinj kanë përfunduar kursin Komando, duke u bërë pjesë e forcave elitë të Forcave të Armatosura. Kursi Komando XV janë trupat elitare të Forcave të Armatosura që janë stërvitur çdo ditë. Në këtë kurs kanë marrë pjesë të gjitha forcat e FA dhe jo vetëm nga ato tokësore, duke rritur cilësinë dhe sfidën për të qenë pjesë e njësisë elite. Misioni i kursit komando është të transformojë ushtarakët që përzgjidhen të jenë pjesë e kursit komando, nga një ushtarak konvencional, në një ushtarak të përgatitur dhe të aftë për të vepruar në çdo situatë, në kushte të vështira moti dhe terreni në interes të misionit të batalionit. Risi për kursin XV Komando ka qenë pjesëmarrja e efektivëve nga repartet e tjera të FA, gjë që rrit interesin për t'u bërë pjesëtar i këtij batalioni elite.

